

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7854 E mërkurë 17 Prill 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** Ditës

Nga ARMAND SHKULLAKU



Ne e dogjëm vetë katedralen tonë

Heshtja kaploi mbrëmë miliona shqiptarë, ndërsa ndiqnin drejtpërdrejtë djegien e katedrales së Notre Dame të Parisit. Rrallëherë fatkeqësia e një

Vijon në faqen 20

Opinion **i** Ditës

Nga SPARTAK NGJELA



Eliminimi i të korruptuarve, interes rajonal i Perëndimit

Politika është shkollë. Por kjo shkollë ka qenë e pamundur të mësohej nga katërshja Berisha, Rama, Meta dhe Basha. Këta asnjëherë nuk iu ...

Vijon në faqen 21



Parlamenti miraton mocionin e 5 partive

## Holanda rikthen vizat "Shengen" për Shqipërinë, vendimi final i takon BE-së

Arsyeja, rritja e kriminalitetit. PD dhe LSI: Qeveria të reagojë, luftë fenomenit

Nga VALENTINA MADANI

Parlamenti i Holandës miratoi dje mocionin e pranuar në emër të 5 grupeve parlamentare për të anuluar udhëtimin pa viza për shtetasit shqiptarë në zonën Shengen. Për miratimin e këtij mocioni nevojitet shumicë e thjeshtë nga 150 ...

Në faqen 3

EMRAT/ TOKAT E ZENA NGA "INFORMALET", SI NDAHEN 450 MILIONE LEKE

## KOMPENSIMI I PRONAVE, 600 FAMILJET QË MARRIN PARATE

Përfituesit në Tiranë dhe në rrethe. Drejtoresha e Agjencisë së Trajtitimit të Pronave publikon procedurën: 8 dokumentet që duhet të dorëzoni



(Në foto) Ndërtime informale

Në faqen 11-12

KREU I KADASTRES

**Artan Lame: Tokat në bregdet, ja si do të realizohet procesi i regjistrimit**

Në faqen 10

"VIP PAGES"

**Modelja e njohur spanjolle në "Prestige Resort": Mezi po pres...**

Suplement

ZJARRI NË "NOTRE DAME"

**50 vetë në hetim dhe parashikimi i Nostradamus për djegien e katedrales**

Në faqen 19

EKSPOZITA

**Lekë Tasi, artisti që njohu persekutimin në diktaturë, shfaqen vizatimet e një jete**

Në faqen 18

RAPORTI FINANCIAR



**Djegia e mandateve, Kuvendi jep 2 paga shpërblim për ish-deputetët e PD-LSI**


Në faqen 4

Grabitja / Vdekja e 47-vjeçarit, gjykata i jep 2 javë kohë prokurorisë për provat

## "Admir Murataj, nga mësues në grabitës"

Vëllai Can Murataj: 'Robin Hood', guximin e tij e përdorën të tjerët

TIRANË-Vëllai im, Admir ishte 'Robin Hood'. Pasionet e tij ishin miqësia, shoqëria, tavolina, ecja në natyrë. Ai ishte një zemërluan. Sa i peshonte gjithë trupin kishte zemrën. Guximin e tij e përdorën, ndoshta pas 2 vitesh do të dalë një bashkëpunëtor i drejtësisë



dhe do të flasë". Kështu është shprehur dje për mediat Can Murataj, vëllai i Admir Muratajt, i cili mbeti i vrarë me plumb në kokë vetëm pak minuta pas grabitjes spektakolare në aeroportin e Rinasit, gjatë shkëmbimit të zjarrit me Policinë e Shtetit...

Në faqen 7

# INTEGRIMI REFORMAT

Takimi, BE: Integrimi ka nevojë për kompromis, bojkoti nuk i shërben askujt

## Kriza, OSBE: Po tentojmë në çdo formë për dialog pozitiv-opozitë

"Në zgjedhje të marrin pjesë të gjitha partitë"

Valentina Madani

OSBE përmes ambasadorit në vendin tonë, Bernd Borchardt, e konsideron të paarsyeshme zgjatjen e krizës politike, ndaj bën thirrje për dialog mes palëve. Gjatë një takimi me studentët e Universitetit "Luigj Gurakuqi" në Shkodër, Borchardt tha se kriza politike është në dëm të Shqipërisë. Ai konfirmoi se po nxit opozitën dhe qeverinë për dialog. Bernd Borchardt shprehu dëshirën që të gjitha palët të marrin pjesë në zgjedhje. "Po tentojmë në çdo formë që të ketë bisedime. Duam që të gjithë faktorët politikë të marrin pjesë në zgjedhje. Është e pamundur për mua që të shikoj të ardhmen se çfarë mund të ndodhë në Shqipëri. Ne po kërkojmë dhe nxisim të gjitha forcat politike që të marrin pjesë në zgjedhje. Nxisim dialogun dhe një përpjekje të përbashkët për të zgjidhur problemet me të cilat ballafaqohet vendi", tha Borchardt.



Ambasadori i OSBE-së në vendin tonë, Bernard Borchardt

### "Zgjedhorja", Moses dhe Soreca: Koha është tani, udhëheqësit të japin shembull

Ambasadori i BE në Shqipëri, Luigi Soreca dhe e ngarkuara me punën e SHBA-ve, Leyla Moses-Ones apelian dje në adresë të udhëheqësve shqiptarë për më shumë vëmendje dhe politika mbështetëse për gratë e prekura nga kanceri. Në një takim për sensibilizimin ndaj sëmundjes së kancerit, Leyla Moses-Ones i bëri thirrje klasës politike shqiptare për të lënë mënjane ndasitë e tyre dhe të bëhen bashkë për kauza të tilla të rëndësishme. Zyrtarja e ambasadës së SHBA apeloj gjithashtu që palët politike të bashkëpunojnë për reformën zgjedhore dhe të jenë shembull për qytetarët. Nga ana tjetër, e dërguara me punë e SHBA-ve në Tiranë, tha se udhëheqësit dhe politikanët shqiptarë duhet të tregohen më vigilentë dhe të punojnë për interesin e përgjithshëm të vendit. Ajo



rikujtoi edhe reformën zgjedhore, çështje kjo që prej kohësh është pjesë e debatit politik në vend. "Investimi të gratë i ndihmon vendet të arrijnë paqe dhe begati më të madhe. Gjatë viteve të fundit Ambasada e SHBA-ve ka mbështetur angazhimin, politik-social dhe politik të grave në Shqipëri. Unë do të doja të ndaja me ju diçka personale. 12 muaj më parë humba nënën time për shkak të kan-

cerit. Unë e di personalisht se kanceri i gjirit ndikon të gjithë ne. Kanceri i gjirit nuk njih kufij dhe është i verbër ndaj privilegjeve. Diagnoza e kancerit është tragjike për njerëzit. Studiimi tregon se punonjësit e Shqipërisë duhet të punojnë për të ndihmuar gratë, veçanërisht ato me sëmundjen e kancerit. Koha është tani dhe mundësia është këtu. Udhëheqësit duhet të japin një shembull të shkëlqyer, ndoshta edhe për një reformë zgjedhore dhe kjo është e mundur", tha Moses. Gjashtë viteve të fundit BE-ja ka investuar shumë në tregun e punës, por ka ndihmuar edhe grupet vulnerabel, siç janë edhe gratë e prekura nga kanceri. "Ne po përgatisim një program të ri, që do të fokusohet në këto çështje. Unë kam angazhim personal që ky program të shkojë përpara sa më shpejt të jetë e mundur", tha Soreca.

opozita duhet të gjejnë një kompromis për t'i dhënë fund kësaj situatë", tha zy. Angelina Eichhorst. Majlinda Bregu, sekretare e

### Masa për 37 protestuesit e 13 prillit, Bardhi: Burgosje politike

Gjykata e Tiranës liroi dje 34 nga 37 personat e arrestuar për aktet e dhunës në protestën e 13 prillit të organizuar nga opozita para Kryeministrit. Trupa gjyqësore vendosi masën e sigurisë arrest shtëpie për 2 dy protestues, Shemsi Kaloshin e Gezim Almetën dhe 32 u lanë me detyrim paraqitje. Ndërsa tre protestues, Armando Gecaj, Edmond Bushi dhe Dainel Gjata mbetën në qelitë e paraburgimit. Mësohet se prokuroria ka kërkuar "arrest me burg" për 16 prej të ndaluarve dhe "detyrim paraqitje" për 21 të tjerë. Sekretari i përgjithshëm i PD, Gazment Bardhi, duke folur pas vendimit të gjykatës garantoj qeverinë se sa më shumë protestues të fusë në burgje, aq më shumë do mblidhen në protestat e opozitës kundër tyre. Bardhi tha se ky vendim është politik. Sipas tij, Edi Rama po vijon t'i vendosë tjetër damkë vendit dhe kjo është "burgosja politike". "Të jetë i sigurt se nëse vazhdon me dhunën ndaj protestuesve, dhuna do i kthehet mbrapsht", deklaroi Bardhi. Mbi të arrestuarit rëndojnë katër akuzat "Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik", "Goditje për shkak të detyrës", "Prishja e qetësisë publike", "Shkatërrimi i pronës me zjarr" dhe "Shkelja e rregullave mbi lëndët plasëse, djegëse dhe radioaktive".

përgjithshme e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal, edhe pse e një mirë parlamentin shqiptar; nuk preferoi të flasë për krizën politike. Ndryshe nga përfaqësuesit e Brukselit, Bregu nuk përdori gjuhën diplomatike për të shprehur skepticizmin e vendimit të Këshillit Europian në qershor. "Jam e bindur që kjo është një kohë e pasigurisë për të gjithë ne dhe shpresoj shumë që të mos jetë vetëm Brexit, i cili do të eklipsojë të gjithë axhendën e Samiit të Këshillit Europian të qershorit", deklaroi zy. Bregu. Më shumë optimist ishte kryebashkiaku Erion Veliaj, që gjatë fjalës së tij u kërkoj



Parlamenti holandez

vendeve të BE-së të mos kërkojnë perfeksionin të Shqipëria, por t'i japin dritën jeshile, pasi ajo i ka bërë detyrat e përcaktuara nga Brukseli. "E di, situata nuk është perfekte, por perfekte nuk është as Italia, Franca dhe Britania e Madhe. BE-ja duhet të marrë një vendim për Ballkanin Perëndimor. Shqipëria i ka bërë detyrat e saj", theksoi kreu i Bashkisë së Tiranës, Si Veliaj, edhe Bregu u bënë thirrje përfaqësuesve të Ballkanit që të lënë mënjane paragjykimet dhe të qëndrojnë të bashkuar për një vizion të përbashkët, që të ndërtohen ura reale të bashkëpunimit.



LSI: Qeveria të kërkojë dialog me palën holandeze për të frenuar fenomenin

# Krimi, Holanda rikthen vizat për Shqipërinë, por vendos BE

PD: Shqiptarët s'do të lejojnë kthimin në ditët e zeza

Valentina Madani

Parlamenti i Holandës miratoi dje mocionin e pranuar në emër të 5 grupeve parlamentare për të anuluar udhëtimin pa viza për shtetasit shqiptarë në zonën Shengen. Për miratimin e këtij mocioni nevojitej shumicë e thjeshtë nga 150 deputetë gjithsej. Vota pro e detyroi parlamentin që t'i kërkojë qeverisë së Holandës t'i propozojë Komisionit Evropian të iniciojë procedurën e "frenimit emergjent", i cili mundëson pezullimin e udhëtimit pa viza. Më datë 11 prill në parlamentin holandez pati debate mbi këtë mocion, i cili siguroi mbështetjen e shumicës. Propozimi për pezullimin e vizave për shqiptarët në "Shengen" ka ardhur pasi deputetët holandezë kanë shprehur shqetësimin se ka pasur një rritje të konsiderueshme në aktivitetet kriminale nga mafia shqiptare në Holandë dhe këto organizata kriminale po abuzojnë me mundësinë e udhëtimit nëpër Evropë pa viza, duke zgjeruar më tej rrjetin e tyre të kontrabandës. Ndaj, Holanda votoi dje për rikthimin e vizave për Shqipërinë. Pesë partitë politike në Holandë, VVD, CDA, PVV, SP, CU kanë bërë bashkë 92 deputetë, nga 150 duke votuar me shumicë votash kërkesën për heqjen e vizave për vendin tonë. Pesë partitë në Holandë kërkojnë pezullimin e përkohshëm të vizave, për shkak të kriminalitetit të shtuar. Por, pavarësisht vendimit të Parlamentit të Holandës, fjalën e fundit do ta thotë Bashkimi Evropian.

**REAGIMET**

Për nënkryetarin e Partisë Demokratike, Edi Paloka, rikthimi i vizave nga Holanda është dhuratë e një qeverie dhe një kryeministri që jo vetëm po shkatërron të ardhmen, por po na kthen edhe mbrapa në kohët më të errëta. "Nuk ka kaluar shumë nga koha kur në tentativë për të shkuar drejt Perëndimit, qindra jetë shqiptarësh humbën në ujërat e ftohta të detit apo rrëpirat e maleve. I kemi harruar! Kemi harruar radhët e gjata nëpër ambasada! Prindër që prisnin me muaj për një vizë, sepse i kishte marrë malli për fëmijët emigrantë. Vizë që në shumicën e rasteve as nuk arrinin ta merrnin nëse nuk paguanin sekserë e matrapazë jashtë e brenda ambasadave. Nuk ka



**EDI PALOKA**

"Nuk ka nevojë të tregoni mirënjohje as për Berishën e as për Bashën, që bënë të mundur liberalizimin e vizave, por të paktën ngrihuni për vete e mos lejoni që për shkak të një kryeministri monstër të rikthehemi në ditët e zeza kur trajtohem si qytetarë të dorës së fundit nga Evropa", shprehet z.Paloka.

**KLAJDA GJOSHA**

"I bëj thirrje ministrit të Jashtëm të komanduar në mënyrë antikushetuese të mos merret më me targat dhe pasaportat diplomatike, por në mënyrë urgjente të kërkojë dialog me palën holandeze për të frenuar këtë fenomen, që mund të marrë përmasa të papërkrahshme në debatin e ardhshëm të këshillit", - tha ish-ministria e Integritimit.

## "Mazhoranca e re, vizat nuk do të rikthehen"

### 30 qershori, Basha: Data e zgjedhjeve lokale do të shtyhet

Kreu i PD-së Lulzim Basha shprehu mbremë sigurinë e plotë se nuk do të ketë rikthim të vizave pasi sipas tij shumë shpejt Shqipëria do të ketë një mazhorancë të re qeverisëse. "Regjimi me viza nuk do të rikthehet, sepse Shqipëria shpejt do të ketë një mazhorancë që lufton krimin. Kjo që po ndodh është sistematike. Krim në Holandë ka pasur, ka dhe do të ketë si në çdo vend tjetër të botës. Por kjo që po na ndodh me krimin e organizuar shqiptar është sistematike, sepse, siç e thotë dhe raportit i DASH, Shqipëria është



kthyer në një bazë operationesh të rrjeteve kriminale që vepronë nga Amerika e Jugut në Amerikë të Veriut, nga lindja e mesme në Shqipëri", -tha z.Basha në "Tempora" në Ora News.

Gjatë intervistës kreu i PD-së foli për shtyrjen e datës së zgjedhjeve të 30 qershorit. "Data e zgjedhjeve lokale do të shtyhet. Zgjedhje lokale me 30 qershor nuk ka për të pasur. Ka më drejt se kjo! Pa u ndëshkuar krimi elektorale; duke filluar me krimin elektorale të pushetit vendor me Dibrën e 2016-ës, pa u ndëshkuar përgjegjësit për krimet elektorale, as që mund të mendohet të garantohej një proces zgjedhor. Derisa nuk garantohej një proces zgjedhor si mund të ketë zgjedhje false. Zgjedhje false nuk do të ketë", deklaroi z.Basha.

nevojë të tregoni mirënjohje as për Berishën e as për Bashën, që bënë të mundur liberalizimin e vizave, por të paktën ngrihuni për vete e mos lejoni që për shkak të një kryeministri monstër; të rikthehemi në ditët e zeza kur trajtohem si qytetarë të dorës së fundit nga Evropa", shprehet z.Paloka.

**THIRRJA**

Ish-ministria e Integritimit, Klajda Gjoshja, e konsideroi dje si një vendim të pa precedentë, që ka vendosur

në rrezik një të drejtë që qytetarët shqiptarë e kanë fituar 10 vite më parë. Ajo i bëri thirrje ministrit të Jashtëm që të kërkojë dialog me palën holandeze për të frenuar këtë fenomen. "I bëj thirrje ministrit të Jashtëm, të komanduar në mënyrë antikushetuese të mos merret më me targat dhe pasaportat diplomatike, por në mënyrë urgjente të kërkojë dialog me palën holandeze për të frenuar këtë fenomen, që mund të marrë përmasa

të papërkrahshme në debatin e ardhshëm të Këshillit, pra të vendeve anëtare. I bëj thirrje ministrit të Brendshëm të ndalë menjëherë arrestimet e qytetarëve që protestojnë paqësisht në të drejtën e tyre dhe të merret seriozisht me të gjitha instancat që ai drejton, për të luftuar krimin e organizuar që nuk ka destabilizuar tashmë jo vetëm Shqipërinë, por është prezent përtej kufijve tanë", deklaroi zj.Gjoshja.

**PETRIT VASILI**

"Lajm shumë i hidhur. Holanda votoi që shqiptarëve t'u vendosen vizat. Shqiptarët për shkak të kriminalizimit të qeverisë dhe kryeministrit dënohen që t'u vendosen sërish vizat. Kryeministri dhe qeveria nuk e luftojnë krimin, por mbështeten tek ai dhe përdoren prej tij", tha z.Vasili.

## Rikthimi i vizave? MEPJ:

### Shkak klima politike në Holandë

Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme e Shqipërisë ka reaguar dje në lidhje me vendimin e parlamentit të Holandës për rikthimin e vizave për shqiptarët. MEPJ e konsideron votimin në parlamentin holandez për rikthimin e vizave si të lidhur me klimën elektorale dhe jo pasojë e situatës në Shqipëri. Sipas ministrisë, Shqipëria është futur në agjendën e partive në garë për zgjedhjet në Holandë. "Klima elektorale në Holandë padyshim ka ndikimin e vet dhe edhe pse jemi të keqardhur për futjen e Shqipërisë në agjendën e partive në garë, s'kemi asnjë dyshim në faktin se përtej horizontit të zgjedhjeve evropiane faktet do të prevalojnë mbi klishetë elektorale", - thuhet në njoftimin e Ministrisë së Jashtme. Pavarësisht votimit të Dhomës së Dytë të Përfaqësuesve në parlamentin holandez për t'i kërkuar Bashkimit Evropian iniciimin e procedurës për pezullimin përkohshëm të liberalizimit të vizave, ministria thotë se nuk ndryshojnë rregullat e lëvizjes drejt vendeve shengen. "Shtetasit shqiptarë do të vazhdojnë të lëvizin të lirë drejt vendeve shengen sipas praktikës të derisotme dhe duke plotësuar vetëm kushtet aktualisht në fuqi", - thuhet në njoftim. Sipas ministrisë rezoluta e parlamentit holandez nuk do të gjëjë mbështetje në Komisionin Evropian. "Gjithsesi është Komisioni Evropian që do të shqyrtonte kërkesën dhe do t'i japë përgjigje asaj. Duke gjuvkuar objektivisht, në bazë të fakteve dhe shifrave zyrtare, Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme është besimplotë se rezoluta në fjalë nuk mund të gjëjë mbështetje në Komisionin Evropian, pasi asnjë nga kriteret që do të çonin në aplikimin e mekanizmit të pezullimit të përkohshëm nuk është plotësuar në rastin e Shqipërisë", - thuhet në këtë deklaratë.

**Njoftim shtjete me anand**

Shoqëria përmbarimore "AA Bailiff" shpk, zhvillon ankandin e III-të, për shitjen e pasurisë së paluajtshme, Trulli 310 m2 dhe ndërtesë 96 m2, me nr. pasurie 170/14, Vol. 8, Fq. 154, ZK. 3852, në pronësi të Ruzhdi Demir Tropini e regjistruar në ZVRPP Durrës

Cmimi i ankandit të trete është EUR 21,600 (njëzetë e një mijë e gjashtëqind euro)

Ankandi zhvillohet dt. 10/05/2019, ora 16.00 në adresën Rruga e Kavajës, Ndërtesa 27, Hyrja 1, Kati i III-të, Tiranë. Kontakt: cel. 0688012846, ose në adresën e email: aabailiff@gmail.com.

## KUVENDI ISH-DEPUTETËT

Të zgjedhurit që lënë mandatin do të marrin nga 300 mijë lekë në mënyrë të menjëhershme

# Kuvendi dy paga shpërblim për të gjithë ish-deputetët e opozitës

### Ligji u jep atyre gjysmë page për 3 vjetët e ardhshëm

Ish-deputetët e opozitës që lanë mandatet pas një vendimmarrje politike të partive që përfaqësojnë, do t'i gëzojnë edhe për disa kohë të tjera privilegjet dhe të mirat që i jepet funksioni që kanë pasur. Kuvendi i Shqipërisë i ka dhënë atyre dy paga shpërblim në momentin e dorëzimit të mandatit dhe largimit të funksionit që mbanin deri në muajin shkurt. Këtë e kanë bërë të ditur burime nga institucioni i Kuvendit, të cilat kanë konfirmuar nxjerrjen e urdhrorit për dhënie të dy pagave shpërblim. Në total bëhet fjalë për një shumë prej afro 300 mijë lekësh të rinj që i janë dhënë secilit deputet të opozitës në mënyrë të menjëhershme. Në fakt, nuk bëhet fjalë për një favorizim nga ana e Kuvendit, por për një detyrim që lind nga ligji nr.8097, datë 21.3.1996 "Pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", të ndryshuar. Kështu në nenin 1, pika 8 e këtij ligji përcaktohen grupet e funksionarëve që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, ku deputetët përfshihen në grupin "b". Ndërkohë që neni 7 i po këtij ligji përcakton se funksionarët e grupit "b", "pas largimit nga funksioni, u jepen dy paga mujore të funksionit". Sipas përcaktimit që bëjnë ligjet e tjera, paga e një deputeti sot është 156 mijë lekë të reja bruto dhe ish-deputetëve të opozitës i janë dhënë dy të tilla. Gjithsesi nuk dihet nëse ky urdher është ekzekutuar ende nga Ministria e Financave, e cila në bazë të ligjit të mësipërm do t'i duhet të bëjë dhe lëvizimin e fondit përkatës. Por jo vetëm kaq pasi ish-deputetët e opozitës nuk do u duhet të punojnë të pakten edhe për 3 vite të tjera. Kjo për vetë faktin se ligji i sipërcituar përcakton se të gjithë funksionarët e lartë shtetërorë, përfshi edhe deputetët përfitojnë pagesë edhe për 3 vite të tjera pasi lënë detyrën apo funksionin e caktuar. Dhe në rastin konkret sa i përket deputetëve ky ligj përcakton

se "Personave të grupit të parë, që përmenden në shtojtën "b", pas largimit nga funksioni, marrin 50 për qind të pagës referuese, për aq kohë sa kanë punuar në funksione të tilla, por jo më shumë se 3 vjet nga momenti i largimit nga ky funksion". Në këtë mënyrë të gjithë ish-deputetët e opozitës që në 2017 u zgjidhën për herë të parë do

marrin gjysmë page çdo muaj për një periudhë kohore mbi 2 -vjeçare, ndërsa të gjithë deputetët e tjerë që kanë më shumë se 1 mandat do të marrin pagesë gjysmë rroge për 3 vite të tjera. Nisur nga fakti se paga e një deputeti shkon në 156 mijë lekë bruto, ish-deputetët e opozitës do të marrin për 3 vjetët e ardhshme rreth 780 mijë lekë të rinj çdo muaj. Një

shumë kjo që shkon më shumë se sa është një pagë mesatare në Shqipëri. Natyrisht që lënia e mandateve në bllok nga një numër i madh deputetësh dhe zëvendësimi në anën tjetër i tyre me deputetë të rinj do të sjellë një rëndim të buxhetit të shtetit për vitin ekzistues, pasi njëkohësisht do duhet të paguajë edhe ata që ikën dhe ata që erdhën.



### Nga paga, karburanti, telefoni dhe dietat, ja të ardhurat e deputetit

Të ardhurat e një deputeti përbëhen nga dy pjesë: paga dhe të ardhurat për shkak të Statusit të Deputetit. Paga e një deputeti është rreth 156 mijë lekë të rinj, nga të cilat pasi mbahen sigurimet shëndetësore, shoqërore dhe taksat mbi pagë, shkon në 115 mijë lekë të rinj. Por ajo që përbënë burimin kryesor të të ardhurave të një deputeti nuk është paga, por të ardhurat e tjera dhe favoret që vijnë për shkak të Statusit të Deputetit. Kështu një i zgjedhur i Kuvendit të Shqipërisë përfiton të ardhura si pagesë për karburantin, telefonin, dieta, honorarë, pagesë hoteli apo qiraje. Të gjitha këto të ardhura shkojnë deri në 200 mijë lekë në muaj për një deputetë, pra dukshëm më e lartë edhe se sa paga. Më konkretisht një deputetë merr afërsisht 40 mijë lekë për karburantin, 17 mijë lekë për telefonin celular, 137 mijë lekë dieta dhe pjesa tjetër pagesë hoteli ose qiraje.



Gjatë një seance parlamentare

### LIGJI, JA FUNKSIONARËT QË PËRFITOJNË SHPËRBLIM DHE PAGESË SHTESË

■ NENI 1

**Pika 8.** Në termin "Grupi i parë" do të përfshihen: a) Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryetari i Këshillit të Ministrave, zëvendëskryetari i Këshillit të Ministrave, ministrat, zëvendëskryetari i Kuvendit dhe të barazuar me ligj me ta, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm dhe Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit. b) Deputetët e Kuvendit, anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, anëtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, si dhe Avokati i Popullit, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive".

■ NENI 7

"Personave të grupit të parë, që përmenden në shkronjën "a" të pikës 8 të nenit 1, pas largimit nga funksioni, u jepen tri paga mujore të funksionit dhe pas këtyre pagave marrin 50 për qind të pagës referuese, për aq kohë sa kanë punuar në funksione të tilla, por jo më shumë se 3 vjet nga momenti i largimit nga ky funksion. Personave të grupit të parë, që përmenden në shtojtën "b" të pikës 8 të nenit 1, pas largimit nga funksioni, u jepen dy paga mujore të funksionit dhe pas këtyre pagave marrin 50 për qind të pagës referuese, për aq kohë sa kanë punuar në funksione të tilla, por jo më shumë se 3 vjet nga momenti i largimit nga ky funksion. Personave të grupit të dytë, që përmenden në shtojtën "a" të pikës 9 të nenit 1, pas largimit nga funksioni, u jepen dy paga mujore të funksionit dhe pas këtyre pagave marrin 40 për qind të pagës referuese, për aq kohë sa kanë punuar në funksione të tilla, por jo më shumë se 1 vit nga momenti i largimit nga ky funksion."

■ PAGESA

Ligji përcakton se të gjithë funksionarët e lartë shtetërorë përfshi edhe deputetët përfitojnë pagesë edhe për 3 vjet të tjera pasi lënë detyrën apo funksionin e caktuar. Dhe në rastin konkret sa i përket deputetëve ky ligj përcakton se "Personave të grupit të parë, që përmenden në shtojtën "b", pas largimit nga funksioni, marrin 50 për qind të pagës referuese, për aq kohë sa kanë punuar në funksione të tilla, por jo më shumë se 3 vjet.

Fondacioni "Islamic Relief Worldwide" e ka zanafillën në Shqipëri në vitin 1991. Islamic Relief- Albania office është regjistruar si një organizatë ndërkombëtare në Shqipëri me vendim gjykatë nr. 44 me 14 Korrik 1994. Aktualisht Fondacioni operon në rrethet Shkodër e Tiranë, në qytetin e Pogradecit, Korçë, Kavajë dhe atë të Lushnjës me projekte të ndryshme zhvillimore në sektorë të edukimit, infrastrukturës, rritjes së kapaciteteve, mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut, shëndetësisë dhe në projekte sezonale si Qurbani dhe Ramazani.

**FTESE PER OFERTE**

01.04.2019

Fondacioni Islamic Relief- Albania Office ka hapur ftesën për ofertë me objekt:

**"Blerje Produktesh Ushqimore"**

Parashikohen të përgatiten rreth 1500 pako ushqimoresh, 1 pako ushqimesh do të përmbajë:

Orize 5kg, Makarona 2.5kg, Sheqer 2kg, Miell 5kg, Vaj Luledielli 5 Liter, Hurma Arabie (0.5 kg), Fasule 1kg.  
Per detaja ne lidhje me kerkesat per kete ftese ne tender, klikoni ne faqen zyrtare te Facebook: Islamic Relief Albania

Oferta juaj duhet të jetë në një zarf të mbyllur dhe të vulosur dhe duhet dërguar në adresën: Adresa: Laprake, rruga e Durrësit, Blloku Gintash, pall E, kati i II, ap 8, Tirana ose mund ta dergoni ne posten elektronike: info@islamicrelief.al Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është më datën 18.04.2019. Për çdo pyetje ju lutem mos hezitoni t'i adresoni në: info@islamicrelief.al ose te kontaktoni ne:

Tel.: +355 42413190, 0676006767



**Investimet për vitin 2018 janë realizuar 80.28 % të planit**

**Kuvendi i Shqipërisë bleu vitin që shkoi 350 milionë lekë makina**



Investimet kapitale zënë, gjithashtu, një vend të rëndësishëm në shpenzimet vjetore që kryen Kuvendi i Shqipërisë. Kështu ligji "Për buxhetin e vitit 2018" i ka akorduar Kuvendit 124 milionë lekë investit, nga buxheti i shtetit dhe 25 milionë me financime të huaja, ku përfshihet projekti "Instalim i sistemit audio video në sallat e mbledhjeve të Komisioneve Parlamentare". Ky projekt, i financuar në kuadër të projektit të binjakëzimit IPA është tenderuar, ndjekur në realizim kontrate dhe financuar nga Ministria e Financave, CFCU. Por për vitin 2018, nuk është bërë kalim kapital apo procedurë marrjeje në dorëzim nga Ministria e Financave tek Kuvendi i Shqipërisë për këtë investim. Një nga investimet më të rëndësishme

të Kuvendit në vitin që shkoi rezultoi të ketë qenë blerja e disa automjeteve. Në relacionin e shpenzimeve buxhetore, ky institucion ka raportuar vetëm shumën

prej 35.2 milionë lekë të reja për blerje autoveturash, por pa bërë të ditur se sa është numri i saktë i tyre. Burime nga Kuvendi bënë të ditur dje se bëhet fjalë për 4 au-

tovetura që përdoren për drejtuesit, delegacionet dhe administratën. Gjithashtu, Kuvendi raporton se është bërë rikonstruktion i ambienteve të brendshme të Kryesia e Kuvendit, është ndërtuar një pikë për konferenca për mediat si dhe një vendqëndrim për gazetarët. Gjithashtu, Kuvendi raporton se ka blerë edhe një sistem sigurie për emailin, si dhe një pikë për transmetim livestream. Siç shihet nga tabela që shoqëron këtë raport, një pjesë e investimeve janë realizuar përfundimisht, duke shënuar një realizim të 80.28 % të planit të tyre.

**Shpenzimet për udhëtime zënë 15 % të të gjithë shumës së buxhetit të Kuvendit**

**Raporti, 150 urdhra udhëtimi jashtë shtetit për deputetët në 2018**

*Vetëm ujë dhe kafe për deputetët në lokalin e Kuvendit*

Shpenzimet për pagat dhe të ardhurat e tjera që përfitojnë deputetët përbëjnë pjesën kryesore të buxhetit që harxhon Kuvendi i Shqipërisë në një vit. Kuvendi ka publikuar relacionin për shpenzimin e buxhetit për vitin 2018, ku rezultoi se 53 për qind e tij harxhohet ose shkon për përfitime financiare të deputetëve. Këtu hyjnë pagat, pagesat e karburantit, telefonisë, dietat, qiratë, pagesat e hoteleve etj. Në vend të dytë sipas këtij raporti janë shpenzimet për udhëtime dhe pjesëmarrje të deputetëve jashtë shtetit. Në total ky lloj shpenzimi zë 15 për qind të të gjithë shumës së buxhetit të Kuvendit për vitin 2018. Gjatë vitit 2018 Kuvendi raporton se janë lëshuar rreth 150 urdhra udhëtimi, në të cilët theksohet lloji i aktivitetit, përbërja e delegacionit pjesëmarrës, itinerari i udhëtimit, dhe cilat shpenzime mbulon Kuvendi i Shqipërisë. Nga këto urdhra, 16 kanë qenë me shpenzimet e palës pritëse (me rimbursim). Këto udhëtime janë pjesëmarrje në Asamble parlamentare të NATO-s, AP të OSBE, PAM, PABSEC e aktivitetet të tjera ndërkombetare. Siç shihet nga grafiku që shoqëron këtë raport shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit në 2018 janë rritur në krahasim me vitin 2017, teksa në total kjo shumë shkon rreth 46.5 milionë lekë. Një tjetër zë është ai shpenzimeve për pritje e përcjellje delegacione të huaja, i cili përfshin shpenzimet për akomodim, dreka, apo takime zyrtare të delegacioneve parlamentare të huaja



Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Gramoz Ruçi me presidenten e Senatit Maria Elisabetta Alberti Casellati

në Shqipëri. Këto shpenzime planifikohen mbi bazën e një programi të vizitës zyrtare apo aktivitetit dhe të miratuar paraprakisht. Në kuadër të mirëmenaxhimit të shpenzimeve për pritje e përcjellje në zyrë, në ambientet e sallës së seancave apo të sallës VIP në aeroport, në këtë relacion bëhet ditur se deputetëve dhe zyrtarëve të lartë u ofrohet kryesisht kafe dhe ujë. Ndërkohë që në institucion mësohet se është shpërndarë një urdhër i brendshëm që vë përgjegjësitë për kontrollin

dhe firmosjen e këtyre shpenzimeve në fletë daljet e Drejtorisë së Shërbimit Qeveritar që i ofron këto shërbime. Një tjetër zë i rëndësishëm në shpenzimet e Kuvendit për vitin që lamë pas raportohet të kenë qenë edhe ato për mirëmbajtjen e sistemeve elektronike dhe pajisjeve të tjera. Ky grup shpenzimesh rezultoi në vlera të konsiderueshme, për shkak të nevojave për mirëmbajtje të sistemeve të tilla si: sistemi e-parlament; sistemi elektronik i votimit,

sistemi i sigurisë me kamera; rrjeti wireless; pajisjet e tilla si kondicionerë nëpër zyrë; gjeneratorë; fotokopjatoricet; skanerët e sigurisë; ashensorët, autoveturat etj. Rritja e vlerës së këtyre shpenzimeve nga viti në vit sipas raportit shpjegohet me amortizimin e pajisjeve dhe sistemeve ekzistuese që kërkojnë shpenzime shërbim mirëmbajtjeje në rritje dhe me kërkesat e VKM nr.710 datë 21.08.2013 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit" për sigurimin e mirëmbajtjes së planifikuar gjatë 2-4 vjet. Një tjetër grup shpenzimesh janë ato për energji elektrike, ujë, shërbime postare dhe telefoni. Realizimi i këtyre shpenzimeve nga viti në vit kanë qenë në rënie duke theksuar se nuk realizohen shpenzime për telefoninë celulare të funksionarëve, për të cilët vendimi i Këshillit të Ministrave parashikon shpenzim nga buxheti i shtetit. Kjo për faktin se po ky vendim kërkon lidhjen nga ana e institucionit të një kontrate me një nga operatorët e telefonisë mobile, gjë që nuk është realizuar.

**URDHRI**  
Në kuadër të mirëmenaxhimit të shpenzimeve për pritjet e përcjelljet në zyrë, në ambientet e sallës së seancave apo të sallës VIP në aeroport, në këtë relacion bëhet e ditur se deputetëve dhe zyrtarëve të lartë u ofrohet kryesisht kafe dhe ujë. Ndërkohë që në institucion mësohet se është shpërndarë një urdhër i brendshëm që vë përgjegjësitë për kontrollin dhe firmosjen e këtyre shpenzimeve në fletë daljet e Drejtorisë së Shërbimit Qeveritar që i ofron këto shërbime.

**Ruçi: Integrimi në BE mbetet nxitja e vetme për vendet e Ballkanit**

Nga Italia ku po zhvillon një vizitë zyrtare, kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Gramoz Ruçi konfirmoi edhe një herë se Shqipëria mbështet dialogun Kosovë-Serbi. Ai u prit nga Presidentja e Senatit Maria Elisabetta Alberti Casellati dhe Presidenti i Dhomës së Deputeteve Roberto Fico. Ruçi gjatë këtij takimi shprehur mirënjohjen e Shqipërisë për mbështetjen që ka dhënë në vazhdimësi Italia, ndërsa theksoi se procesi i integritimit në BE mbetet nxitja e vetme për vendet e Ballkanit Perëndimor. "Shqipëria i është mirënjohëse Italisë për rolin pozitiv ndaj Kosovës, veçanërisht për votën e saj në Interpol dhe qëndrimin e saj mbi Forcat e Sigurisë së Kosovës. Shqipëria mbështet Kosovën në procesin e integritimit evropian. Populli kosovar e meriton liberalizimin e vizave dhe Shqipëria inkurajon vendet e BE-së të votojnë për liberalizimin e vizave sa më shpejt që të jetë e mundur. Shqipëria mbështet dialogun Kosovë-Serbi, të lehtësuar nga BE. Rezultati përfundimtar duhet të jetë një marrëveshje ligjore detyruese për njohjen reciproke që sjell anëtarësimin e Kosovës në OKB dhe BE, si dhe trajtimin e drejtë të pakicave, bazuar në Kushtetutën e Kosovës", tha Ruçi. Presidentja e Senatit Casellati nënvizoi vazhdimin e bashkëpunimit me Shqipërinë, ndërsa vlerësoi reformat e ndërmarra nga qeveria. "Bashkëpunimi me Shqipërinë është solid, i vazhdueshëm dhe i gjithanshëm, i mbështetur në miqësinë e fortë midis të dy popujve. Ne vlerësojmë reformat e kryera në Shqipëri, sidomos reformat në drejtësi, një reformë të vështirë, e cila po rindërtton besimin e qytetarëve të drejtësisë. Mbështetja jonë për integrimin e Shqipërisë buron nga roli i Italisë si themeluese dhe kontribuese e paqes, demokracisë dhe ekuilibrave të BE-së. Italia është qartësisht në mbështetje të afimit dhe pranimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE", tha Casellati.

Krimet e Rënda e lënë në qeli, ja akuzat që rëndojnë mbi 29-vjeçarin

# Ish-komando kërcënon prokurorin e gjykatësin: Do jepni llogari, nuk do kaloni kollaj

## Erzen Uka refuzon të ngrihet në këmbë në sallën e gjyqit: Respektoj vetëm Allahun

TIRANË

Gjykata për Krime të Rënda dje vendosi masën e sigurisë "Arrest me burg" pa afat ndaj ish-komandos së ushtrisë, Erzen Uka, i cili u arrestua pak ditë më parë për akuzën e nxitjes së urrejtjes me qëllim kryerjen e akteve terroriste. Gjatë seancës së djeshme që u zhvillua me dyer të mbyllura ka pasur tensione, pasi 29-vjeçari i pandehur ka kërcënuar prokurorin Eugen Beci dhe gjyqtarin Bib Ndreca. Uka ka deklaruar se ata do të japin llogari sapo të dalë nga burgu. E ndërsa, përfaqësuesi i organit të akuzës ka kërkuar që ish-komando të mbetet në qeli, ky i fundit është rebeluar. Ish-komando nuk ka pranuar të ngrihet në këmbë para trupit gjyqës, duke thënë se respekton vetëm Allahun. "Nuk pranoj të ngrihem në këmbë, respektoj vetëm Allahun. Nuk do të qëndroj gjithë jetën në burg, sa të dal, do të jepni llogari dhe nuk do ta kaloni kollaj", është shprehur Erzen Uka, i cili akuzohet për 3 vepra penale. Konkretisht, 29-vjeçari me origjinë nga Kruja akuzohet për sërviçia për kryerjen e veprave penale me qëllime terroriste, nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave penale me qëllime terroriste dhe prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit. Uka kishte më shumë se dy vite që hetohej nga Prokuroria e Krimeve të Rënda dhe konsiderohet person me rrezikshmëri të lartë. Ai ka shërbyer në Irak dhe Afganistan në vitin 2011 është arrestuar nga zyra Antiterrorit në Policinë e Shtetit. Ish-komandoja (i divorcuar) është proceduar më parë për dhunë në familje. Në kanalën e tij në "YouTube" ai ka postuar video duke stërvitur personat dhe qëllimi sipas prokurorisë ishte kryerja e akteve terroriste. Gjithashtu, në një video tjetër ai shihet duke stërvitur dy djemtë e tij të mitur.

### ARRESTIMI

"Specialistët e Drejtorisë së Antiterrorit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit pas një hetime dyvjeçar me metoda speciale të hetimit bënë arrestimin në flagrancë të shtetasit E.U., 29 vjeç, lindur



Ish-komando, Erzen Uka



29-vjeçari Uka në gjykatë

## Qendra Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm: Të mbrojmë shoqërinë nga radikalizmi

TIRANË - Qendra Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm u krijua nga qeveria në 2018, pasi vitet e fundit disa shtetas shqiptarë u bashkuan me organizatat ekstremiste si ISIS në Siri dhe Irak. Pas krijimit të Shtetit Islamik disa prej tyre morën me vete në Siri edhe gratë dhe fëmijët. Numri mendohet të jetë mbi 140 shqiptarë, burra, gra dhe fëmijë, disa prej të cilëve janë kthyer tashmë në Shqipëri. Strategjia kombëtare e qeverisë për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm synon një rol shumë më aktiv të shkollës apo institucioneve fetare, për t'u përbalhur me propagandën radikalizuese dhe ekstremiste, që tenton të prekë nxënësit, studentët, rininë dhe personat e marginalizuar. Prej 9 muajsh kjo qendër ndihmon përmes projekteve komunitet në mbarë vendin dhe trajnon rreth 20 mijë mësues, policë, psikologë dhe punonjës socialë të konsideruar si të vijës së parë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmin që çon në terrorizëm. Qendra



është në varësi direkte nga zyra e kryeministrit. Nuk mungojnë bashkëpunimet e qendrës me organizatat ndërkombëtare dhe departamentin amerikan të shtetit. Një memorandum bashkëpunimi u nënshkrua këtë të hënë me drejtorin të qendrës zotit Agron Sojati dhe drejtueses së zyrës së Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin në Shqipëri, zonjës Alma Jani. Drejtori i qendrës tregon se u janë caktuar detyra të veçanta çdo ministrie, me qëllim parësor

mbrojtjen e shoqërisë shqiptare nga ekstremizmi i dhunshëm. "Sot ju patë edhe planin e detajuar të veprimtari, ku çdo ministri merr angazhime dhe Shqipëria vjen me buxhet në çdo linjë për çështjen e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit. Pjesa me IOM, siç është edhe bashkëpunimi që ne kemi me Departamentin e Shtetit Amerikan, kemi me Mbretërinë e Bashkuar, apo me Bashkimin Europian, janë fonde që shkojnë drejt-përdrejt në projekte komu-

nitare. Qëllimi është që të përfshihet gjithë komuniteti, ndoshta jemi në një risi, pasi kemi mbi 20 mijë aktorë të vijës së parë, ku përfshihen mësuesit policët në komunitet punonjësit socialë, psikologët dhe të bashkive në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe religjionet. Ky projekt ka qëllim t'u afrohet nevojave dhe të përkthejë problemet e komunitetit. Qendra është në bashkëpunim me grupet e punës në çdo ministri dhe rrjetin e shoqërisë civile", - tha Agron Sojati, drejtor i qendrës kundër ekstremizmit të dhunshëm. Qendra bashkëpunon edhe me USAID-in. Bashkëpunimi konsiston në zhvillimin e kapaciteteve të aktorëve të ndryshëm si dhe në promovimin e vlerave të tolerancës dhe harmonisë fetare, sundimit të ligjit e demokracisë. Në fund të këtij muaji qendra kundër ekstremizmit të dhunshëm do të organizojë një konferencë me përmasa të mëdha me gjithë aktorët e përfshirë në luftën kundër radikalizmit.

dhe shpërndarë video e pamje filmike që nxisin dhe propagandojnë veprat penale me qëllime terroriste", thuhet ndër të tjera në njoftimin zyrtar të Policisë së Shtetit. Ndërkaq, mësohet se gjatë kontrollit të banesës së tij,

policia gjeti dhe sekuestroi në cilësinë e provës materiale një sasi fiskekësh luftarak. Materiale procedurale iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda për veprat penale "Stërvitja

për kryerjen e veprave penale me qëllime terroriste", "Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave penale me qëllime terroriste" dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit".



Dyshime për lidhje me ISIS, dëbohet imami shqiptar nga Italia

ITALI - Një imam shqiptar do të dëbohet sot nga shteti italian për lidhje të dyshuara me ISIS. Sipas asaj që shkruajnë mediat italiane, bëhet fjalë për shqiptarin me origjinë maqedonase, Zejnullah Sadiki. Emri i Sadikit nuk është i panjohur për mediat italiane. Në vitin 2015, në provincën e Grossetos u zbulua një celulë xhihadiste, ku emri i imamit Sadiku u laka së bashku me Maria Gulia Sergio, alias Fatima, e para grua xhihadiste në shtetin italian. Ndërkohë, lajmin e largimit e ka bërë vetë Sadiku në "Facebook".

### POSTIMI I PLOTË

"Të nderuar vëllezër dashamirë eselamuale-jukm!

Nga mëngjesi i ditës së hënë, ora 06:00, me urdhrin e ministrit të Brendshëm të Italisë, Mateo Salvini, jam i arrestuar nga forcat e rendit në shtëpinë time, pa asnjë dëshmi, me arsye kinse unë jam person i rrezikshëm për shtetin italian duke theksuar këto fakte:

Se unë jam një imam gjithnjë radikal.

Se kam frekuentuar shumë qendrat islame.

Se po merrem me (logistik) me organizim të jetës islame.

Për shkakun se jam familjarizuar këtu në Itali si një imam me përvojë.

Nga dita e hënë në mbrëmje po mbahem në qendrën e emigrantëve në Torino, ku nuk merret vesh se çfarë po bëhet...

Për shkak të kushteve aktuale që gjenden nuk mund të shkruaj më shumë.

Allahu ua pranofte xhuanit të gjithëve dhe bëni dua për mua.

E di se sot xhuma xhematit i kam munguar, por ju them se nëse akoma ka drejtësi dhe demokraci në shtetin italian do të kthehem përsëri", - shkruan shqiptari.

Vdekja 47-vjeçarit, gjykata i jep 2 javë kohë prokurorisë për provat

TIRANË

Vëllai im, Admiri ish te 'Robin Hood'. Pa sionet e tij ishin miqësia, shoqëria, tavolina, ecja në natyrë. Ai ishte një zemërluan. Sa i peshonte gjithë trupin kishte zemër. Guximin e tij e përdorën, ndoshta pas 2 vitesh do të dalë një bashkëpunëtor i drejtësisë dhe do të flasë". Kështu është shprehur dje për mediat Can Murataj, vëllai i Admir Muratajt, i cili mbeti i vrarë me plumb në kokë vetëm pak minuta pas grabitjes spektakolare në aeroportin e Rinasit, gjatë shkëmbimit të zjarrit me Policinë e Shtetit. Një javë pas kësaj ngjarjeje, vëllai i 47-vjeçarit ka treguar detaje nga jeta e Admirit, ndërsa u shpreh se ai ka ushtruar profesionin e mësuesit para se të ikte me gruan dhe fëmijët në drejtim të Greqisë. Sipas tij, Admiri ka punuar si murator në Greqi dhe prej andej u kthye i zhgënjyer nga jeta, teksa i kishte treguar atij se Greqia "kishte marrë fund". Gjithashtu, Can Murataj ka pohuar se Admiri iu kthye grabitjeve të mëdha në vitin 2014. Nga ana tjetër, Murataj është shprehur se kërkon drejtësi për të vëllanë që ndodhet në burg, Aleksandrin, pasi sipas tij, nuk ka asnjë provë për akuzat dhe se deri më tani është mbajtur si peng i Admirit. Ndërkaq, dje Gjykata e Krimeve të Rënda i ka kërkuar prova prokurorisë që të vërtetojë se personi që u vra me 9 prill është Admir Murataj.

**RRËFIMI I CAN MURATAJ**

"Admiri ka qenë mësues, më tej iku nga mësuesia. Ai mori gruan e tij dhe fëmijët dhe iku në Greqi. Punoi atje murator, por pasi disa vitesh u rikthye i zhgënjyer nga jeta atje. I thashë: Vëllai ik nga Greqia, Evropa është e madhe! Të jeni të bindur tek Zoti, se ka filluar punën në Greqi murator, mori një magazinë supermarket për mirëmbajtje", tha Can Murataj. I pyetur për identitetet që përdorte, Murataj tha se këtë vëllai e kishte bërë për motive përfitime, duke treguar se shumë shqiptarë përdorin një strategji të tillë në të gjithë Greqinë. "I ka ndërruar emrat për motive përfitimi. Po nuk ishte Thanasi në Greqi, nuk t'u hapnin dyert. Më erdhi e më tha Greqia ka marrë fund. Admiri kishte rënë 16 kile në peshë, nuk e kanë njohur si njeri. Në vitin 2014-ën iu kthye grabitjeve në shumta të mëdha", - u shpreh vëllai i Admir Muratajt. Gjithashtu, Can Murataj sqaroi se familja e Admirit, gruaja dhe 4 fëmijët kanë jetuar në Tiranë gjithmonë pas kthimit nga Greqia. Ndërsa, përsëriti se nuk kanë pasur asnjë kontakt me vëllain prej vitesh. "Bashkëshortja me 4 fëmijët ka jetuar gjithmonë në Tiranë. Nuk është shkëputur asnjëherë nga Tirana. Që nga historia e Greqisë, nga 2015 e mëbrapa, vetëm kur e dëgjoni në televizor dhe ditët që shkonim në gjykatë, aty e dëgjoni emrin e tij. Më pas

# Can Murataj: Admiri ishte zemërluan dhe 'Robin Hood', guximin e tij e përdorën

## "Vëllai ka punuar si mësues, në 2014-ën nisi grabitjet e mëdha. Aleksandri në burg, ishte peng i Adit"



Can Murataj, duke folur për mediat



Grabitja në aeroportin e Rinasit

**AFATI PËR PROVAT**

Gjykata për Krime të Rënda i dha kohë 2 javë prokurorisë që të vërtetojë vdekjen e Admir Muratajt, procesi ndaj të cilit vijoi gjatë ditës së djeshme. Gjykata ka kërkuar prova që vërtetojnë vdekjen për të mbyllur procesin për akuzat e mëparshme ndaj Muratajt, në lidhje me grabitjet e ndodhura më parë. Gjykata i kërkoj prokurorisë që përsos certifikatën së vdekjes, të paraqesë edhe prova të tjera, si akt ekspertime të vendit të ngjarjes dhe viktimës.

**IDENTITETET E ADMIR MURATAJ**

I pyetur për identitetet që përdorte, Murataj tha se këtë vëllai e kishte bërë për motive përfitime duke treguar se shumë shqiptarë përdorin një strategji të tillë në të gjithë Greqinë. "I ka ndërruar emrat për motive përfitimi. Po nuk ishte Thanasi në Greqi, nuk t'u hapnin dyert. Më erdhi e më tha Greqia ka marrë fund. Admiri kishte rënë 16 kile në peshë, nuk e kanë njohur si njeri.

**VRASJA E SUPERGRABITËSIT**

Admir Murataj mbeti i vrarë pasditen e 9 prillit, pas grabitjes së qindra miliona eurove brenda aeroportit të Rinasit, ndërsa ishte në kërkim si organizatori i 3 grabitjeve me blinda në harkun kohor të 2015-2017. Grupi i tij u dënua gjatë marsit me më shumë se një shekull burg, ndër ta edhe vëllai i Admir Muratajt, Aleksandër Murataj.

**TIRANË** - Një anë tjetër e një njeriu tashmë të ndjerë, të konsideruar "kriminel" për drejtësinë e ligjet, por për të afërmit i mrekullueshëm. Të tillë e përshkruan mbesa, vajza e vëllait Admir Muratajn, 47-vjeçarit që konsiderohet organizatori i grabitjes së Rinasit më 9 prill dhe që mbeti i vrarë pas zjarrit me policinë. Nisur nga përshkrimet e ndryshme, më shumë të aktivitetit të tij kriminal, mbesa ka sjellë një anë tjetër të xhaxhait të saj për t'ia prezantuar publikut. Ilir Murataj, vëllai i Admirit e ka postuar këtë status në profilin e tij në "Facebook".

**STATUHI I PLOTË**

Kush ishte Admir Murataj? Është titull që do e gjeni kudo, në artikuj të shkruar nga gazetarë, të cilët me mënyrat e tyre përpigjen t'i japin përgjigje dhe të analizojnë karakterin, mendjen, jetën dhe vdekjen e tij. Dhe është pikërisht në përpjekje për të përballuar këtë të fundit që edhe unë mundohem t'i tregoj të gjithëve se kush ishte Adit.

nuk kemi pasur asnjë kontakt". Tha Can Murataj. Ai deklaroi se kurrë nuk ka përfituar para nga Admiri dhe gjithsecili ka pasur jetën e

**"Një ditë mund të vijë një kërkesë për film apo dokumentar"**

Ana tjetër e Admir Muratajt, mbesa: I mrekullueshëm për të gjithë, do të mbetet pjesë e historisë

Përmes gjithë lotëve dhe luftës me veten për të arritur ta pranoj realitetin dhe atë çfarë ndodhi, për një gjë jam e gëzuar. Jam një ndër pak persona që arriti ta njihje vërtet, që mund të them me gjithë zemër se sa bir, baba, vëlla, xhaxha, dajë dhe mik i mrekullueshëm ishte për të gjithë. Dhe kështu do e kujtojmë gjithmonë, veshur me një bluzë polo, një kapelë sportive dhe Fredin që i shkonte nga mbrapa, nuk mendoj se ka pasur ditë që e kam parë pa një buzëqeshje në fytyrë dhe gjithmonë me dashuri pa kushte për çdo person të zemrës.

Për mua do të mbetet pjesë e historisë, ashtu siç shkruhen artikuj, një ditë familjes tonë mund t'i vijë një kërkesë, për libër, film apo dokumentar por nuk ka fjalë, foto apo video që ta përshkruaj ashtu siç duhet imazhin e tij. Mesa

Madje, Can Murataj pohoi se nga ky moment i bie barra për të mbajtur familjen e vëllait të tij të vdekur. Ai shprehet se do i qajnë hallet me



duket misteri do mbetet mes familjes Murataj, që gjithmonë do e kujtojmë dhe thellë-thellë nuk do ta pranojmë atë që ndodhi, duke menduar se e gjithë kjo nuk ishte e vërtetë dhe ndoshta mendja e tij ka menduar një fund tjetër. Për mua... pavarësisht realitetit, ai do jetë gjithmonë aty, duke ardhur drejt meje me atë të ecurën që mund ta dalloja shumë metra larg, apo duke pritur ta takoj

policinë, por se nuk do jenë bashkëpunëtorë asnjëherë. Cani pretendon se kanë përdorur guximin e Admirit njerëz që nuk i identifikon.

që të me thotë prapë "zerra xhaxhit".

Gjithçka më mbetet të them është kjo:

Një ndër momentet më të vështira në jetë është kur e kupton se nuk mund t'ia tregosh me dashurinë dhe respektin dikujt dhe të bën të duash të kthehesh pas në kohë, prandaj gjithçka mund të them është përqafoni ata që keni afër dhe bëjini një telefonatë atyre që ndodhen larg. "Kush është Admir Murataj" e mori një përgjigje, tani më mbetet t'ju tregoj ku është... gjithmonë në zemrat tona, gjithmonë pran nesh, dhe pranë nënës së tij.

Nëse dikush më pyet për të, do ia ngre emrin sa më lartë dhe prapë nuk do të ishte mjaftueshëm.

Fati im që ndajmë të njëjtat iniciale, A.M..

Madje, e ai tha se ndoshta pas 2 vitesh do të dalë një bashkëpunëtor i drejtësisë dhe do të flasë. I vëllai nuk ngurroi ta quajë 'Robin Hood', Admi-

rin, ndërsa tregoi se pasionet e tij ishin miqësia, shoqëria, tavolina, ecja në natyrë dhe se ishte një zemërluan. "Sa i peshonte gjithë trupin kishte zemër", thotë Cani.

**KËRKESA E GJYKATËS**

A ishte Admir Murataj, ai që u vra pranë Rinasit më 9 prill, pak minuta pas grabitjes spektakolare brenda Aeroportit Kombëtar? Për të deklaruar këtë gjë me sa duket duhen prova të tjera. Gjykata për Krime të Rënda i dha kohë 2 javë prokurorisë që të vërtetojë vdekjen e Admir Muratajt, procesi ndaj të cilit vijoi gjatë ditës së djeshme. Gjykata ka kërkuar prova që vërtetojnë vdekjen për të mbyllur procesin për akuzat e mëparshme ndaj Muratajt, në lidhje me grabitjet e ndodhura më parë. Konkretisht, gjykata i kërkoj prokurorisë që përsos certifikatën së vdekjes, të paraqesë edhe prova të tjera si akt ekspertime të vendit të ngjarjes dhe viktimës. Seanca e ardhës do të mbahet në 2 maj ora 9:00. Admir Murataj mbeti i vrarë pasditen e 9 prillit, pas grabitjes së qindra miliona eurove brenda aeroportit të Rinasit, ndërsa ishte në kërkim si organizatori i 3 grabitjeve me blinda në harkun kohor të 2015-2017. Grupi i tij u dënua gjatë marsit me më shumë se një shekull burg, ndër ta edhe vëllai i Admir Muratajt, Aleksandër Murataj.

Pasojat e qëndresës së opozitës. Qytetarët ankohen për dhunë të tepruar

# Protestuesi: Nuk bëmë akte dhune, policia na sulmoi me gaz lotsjellës

*Kuksiani Xhelal Dida: Si përfundova në spital*

Të paktën pesë policë dhe dhjetëra qytetarë janë plagosur në protestën në Tiranë kur protestuesit dhe policia janë përplasur mes vete gjatë protestës së nëntë të organizuar nga opozita e Shqipërisë në Tiranë. Ministri i Brendshëm i Shqipërisë, Aleksandër Lleshaj, përmes një postimi në Twitter ka thënë se pesë policë janë plagosur dhe janë shtruar në spital. Në protestën e opozitës morën pjesë shumë qytetarë nga e gjithë Shqipëria. Gjatë mbrëmjes së 13 prillit pati edhe përplasje mes policisë dhe protestuesit duke hedhur gaz lotsjellës dhe dhunë ndaj protestuesve. Të shumtë ishin qytetarët që u përballen me gazin lotsjellës, i cili ju solli probleme shëndetësore. Disa prej tyre shkuan në spital për ndihmë mjekësore. Një ndër këta protestues ishte edhe



Xhelal Dida nga Kukësi, i cili i detyruar nga dhuna dhe gazi lotsjellës kërkoi ndihmë mjekësore në ambientet spitalore. Xhelili si mijëra qytetarë të tjerë protestonte kundër taksave të larta, kundër oligarkisë dhe monopoleve të qeverisë. Biznesmeni kuksian përfundoi në spital në gjendje të rëndë shëndetësore menjëherë pas pro-

**PROTESTA**  
Qytetarët që protestojnë kundër qeverisë së kryeministrit Edi Rama, kanë hedhur mjete të forta, shashka dhe lëndë tymuese në drejtim të ndërtesës së Kryeministrit dhe forcave të policisë, ndërsa këta të fundit kanë përdorur gazin lotsjellës për të shpërndarë turmën.

testës. Ai u shpreh: Gjithmonë kam protestuar për të drejtat tona për uljen e taksave për biznesin, çmimin e lartë të karburantit dhe për gjithçka që po bëhet e pa drejtë. Nuk do e harroj kurrë protestën e 13 prillit ishte ora 20:00 ku si gjithë protestuesit protestonim përpara parlamentit, pa shkakuar asnjë dhunë ndaj policisë, por ata na

u kundërpërgjigjen me gazin lotsjellës, e cila ishte një armë vdekjeprurëse, nuk lëvizja dot sytë më dignin dhe kisha probleme me frymëmarrjen. Më pas u detyrova të shkoja në spital gjendja ime u përkëqësua, aty shikova vdekjen me sy", tha Dida. Opozita nga ana e saj ka folur për 15 protestues, mes tyre dhe gazetarë, të cilët janë plagosur ose kanë pasur problem me frymëmarrjen për shkak të gazit të përdorur. Në mbyllje të protestës, kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, falënderoi protestuesit dhe tha se vetëm zgjedhjet e lira e të ndershme mund t'i kthejnë legjitimitetin Parlamentit. "Ne luftojmë për një kauzë të drejtë, për një Qeveri të çliuar nga krimi, për zgjedhje të lira, rend dhe siguri. Klike e krimi të bërë nëshme me qeverinë që kemi përballë do të shembet nga themelet", shkroi Basha në Facebook.



Trafiku i drogës, më 19 qershor nis gjyqi për ish-ministrin, Saimir Tahiri

**TIRANË** - Ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri do të ulet në bankën e të akuzuarve më 19 qershor. Pas përzgjedhjes së gjyqtarëve, dje është caktuar edhe data e seancës së parë ndaj Tahirit, pra 11 ditë para zgjedhjeve lokale. Ardit Mustafaj, Flora Hajredinaj dhe Irena Gjoka, janë tre gjyqtarët që do të shqyrtojnë dosjen penale të ish-zyrtarit të lartë, i cili akuzohet për

Procesi ndaj Tahirit do të zhvillohet me procedurë të përshpejtuar.

favorizim të grupit kriminal Habilaj në trafikun e drogës nga Shqipëria drejt Italisë. Procesi ndaj Tahirit do të zhvillohet me procedurë të përshpejtuar. Ish-ministri kërkoi gjykim të shkurtuar, pa pranuar akuzën, pasi këmbëngul se është i pafajshëm. Bashkë me të, të pandehur janë edhe tre ish-zyrtarët e lartë të Policisë së Vlorës: Jaeld Çela, Gjergj Kohila e Sokol Bode. Prokuroria për Krime të Rënda i mbylli hetimet më 28 shkurt dhe çoi dosjen e Saimir Tahirit në Gjykatë me akuzën për "Trafikim të lëndëve narkotike" në kuadër të grupit të strukturuar kriminal "Habilaj" dhe "Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë". Më 26 mars, Gjykata e Krimeve të Rënda vendosi të nisë gjykimin ndaj ish-ministrit duke mos pranuar pushimin e çështjes.



PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk

Njofton se duke filluar nga data 16 Prill 2019 çmimi maksimal i shitjes me pakicë për 1 paketë për produktet e mëposhtme të duhanit me ngrohje është si vijon:

Nr	Përshkrimi i Produktit	Çmimi prej datës 16.04.2019 (përfshirë TVSh-në)
1	HEETS (SILVER LABEL)	320 Lekë/ paketë

Njoftimi bëhet në përputhje me Udhëzimin nr. 2, datë 28.1.2010 të Ministrisë së Financave "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" (i ndryshuar).

PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk  
Rr. Murat Toptani , Qendra e biznesit Eurocol, Kati i 10,  
1000 Tirana, Albania  
Tel: +355 42 276 670

## HETIMI

**ELBASAN** - Policia e Elbasanit ka vënë dje në pranga një 38-vjeçar, cili dyshohet se ka djegur dy makina gjatë orëve të para të mëngjesit në këtë qytet. Mësohet se në afërsi të Drejtorisë së Policisë në Elbasan është djegur plotësisht automjeti tip "Volkswagen" me targë Aa 595 KP në pronësi të Hysen Hasekiu, dhe një Skoda me targë AA 702 DI në pronësi të Bledar Hox-

## Dogji 8 automjete, përfundon në pranga zjarrvënësi serial

hës. Policia ka bërë të mundur identifikimin dhe kapjen e autorit të krimit. Ndërkohë, nga hetimet është zbuluar se ai ka lidhje edhe me djegien e disa automjeteve të tjera të ndodhura më parë në vende të ndryshme të qytetit të Elbasanit. Mario Toçi, i cili njihet ndryshe edhe si Englent Toçi u prangos gjatë operacionit të koduar "Zjarrvënësi". Sipas bluve, nga hetimet e kryera ai është përfshirë edhe në gjashtë ngjarje të tjera të ngjashme gjatë periudhës korrik 2018-prill 2019.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BANKA E SHQIPERISE  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

## TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje pjesë këmbimi, mirëmbajtje dhe riparim i automjeteve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 4,000,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutjesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje pjesë këmbimi, mirëmbajtje dhe riparim i automjeteve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"

Oftarta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 10 Maj 2019, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



Drejtuasi i "Qëndresa Qytetare": Zero lekë për biblioteka apo kërkim shkencor

# Zbardhen shifrat tronditëse, ja si shpenzohen paratë e studentëve

*Xhemollari: 4 mijë euro në muaj për karburant makinash*



Voltiza Duro

Brenda 6 muajsh uni versitetet publike në vend kanë shpenzuar shuma marra-mendëse për luksin e zyrave, karburant e madje edhe blerje automjesh. Kështu është shprehur drejtori ekzekutiv i organizatës jofitimpruese, "Qëndresa Qytetare", Rigels Xhemollari, gjatë një interviste për "Gazeta Shqiptare". Sipas tij monitorimi është kryer për një periudhë 6 mujore në 7 universitetet publike në vend e më tej ai ka theksuar se shuma totale e shpenzuar nga këto IAL kap vlerën e 1.346.500 euro. Xhemollari shton se shpenzimet më të larta janë kryer për sigurinë e godinave si dhe për pajisje zyrash.

**Cfarë synon monitorimi i universiteteve publike në vend dhe për cilën periudhë është kryer?**

Monitorimi i shpenzimeve të 7 universiteteve është kryer për të bërë publike mënyrën se si shpenzohen paratë e studentëve nisur edhe nga tarifat e larta dhe shërbimet e munguara në universitete. Gjithashtu, nëpërmjet publikimit të këtyre të dhënave 'Qëndresa' kërkon të rrisë nivelin e llogaridhënies së universiteteve dhe përfshirjen e studentëve në qeverisjen e tyre.

**Cilat janë elementet kryesore që janë marrë nën shqyrtim dhe në cilat IAL është bërë monitorimi?**

Ekipi i Qëndresës ka shqyrtuar të gjitha pagesat që këto universitete kanë realizuar nëpërmjet thesarit të shtetit, si edhe tenderët dhe prokurimet publike. Në shqyrtim janë marrë edhe të dhënat e përfituara nga kërkesat për informacion dhe gjetjet e raportit të dhjetorit të publikuar nga KLSH. Fokusi kryesor kanë qenë shpenzimet për investime, sigurimin e shërbimeve, studimet dhe tarifave të larta dhe nivelit të ulët të cilësisë së shërbimit që marrin studentët në universitete.



Drejtori ekzekutiv i organizatës jofitimpruese, "Qëndresa Qytetare", Rigels Xhemollari



Ekipi i Qëndresës ka shqyrtuar të gjitha pagesat që këto universitete kanë realizuar nëpërmjet thesarit të shtetit, si edhe tenderët dhe prokurimet publike. Në shqyrtim janë marrë edhe të dhënat e përfituara nga kërkesat për informacion dhe gjetjet e raportit të dhjetorit të publikuar nga KLSH. Fokusi kryesor kanë qenë shpenzimet për investime, sigurimin e shërbimeve, studimet dhe librat, për të parë edhe disproporcionin mes tarifave të larta dhe nivelit të ulët të cilësisë së shërbimit që marrin studentët në universitete.

**MONITORIMI I UNIVERSITETEVE**

Monitorimi i shpenzimeve të 7 universiteteve është kryer për të bërë publike mënyrën se si shpenzohen paratë e studentëve nisur edhe nga tarifat e larta dhe shërbimet e munguara në universitete. Gjithashtu, nëpërmjet publikimit të këtyre të dhënave 'Qëndresa' kërkon të rrisë nivelin e llogaridhënies së universiteteve dhe përfshirjen e studentëve në qeverisjen e tyre.

**SHPENZIMET**

Universiteti Politeknik i Tiranës, është universiteti që ka shpenzuar më shumë para për këtë periudhë monitorimi me 2.9 milionë euro, ndjekur nga UAMD me 2.8 milionë euro. Organet që mund të konstatojnë nëse ka korrupsion apo jo janë policia dhe prokuroria, por ne shpresojmë që këto gjetje t'u shërbejnë institucioneve, por edhe studentëve për të kërkuar llogari tek drejtuesit e universiteteve për paratë që ata paguajnë.

**Si janë shpenzuar paratë në universitete?**

Edhe pasi Kryeministri i vendit identifikoi si të paarsyeshme sigurimin e godinave universitare me vlera të konsiderueshme nga paratë e studentëve. Bordet e Administrimit dhe Administratorët kanë vazhduar të sigurojnë godinat me të njëjtat vlera, Universiteti i Tiranës ka nënshkruar një kontratë në 7 Mars 2019 për siguri godine në vlerën e 436.500 euro ndërsa Universiteti Politeknik i Tiranës në datën 15 shkurt 2019 ka nënshkruar kontratën po për siguri godinash në vlerën 294.000 euro për 1 vit.

**A konstatohen shpenzime "luksi" jo në dobi të studentit?**

Vazhdojmë të kemi shpenzime luksi për makina, orëdi zyre dhe fasada, shpenzime të cilat nuk lidhen me cilësinë e mësimdhënies. Universiteti "Fan S. Noli" Korçë ka shpenzuar në 6 muaj 24.000 euro karburant, ndërsa Universiteti i "Aleksandër Xhuvani" Elbasanit 22.000 euro po për të njëjtën periudhë. Ndërkohë që Univer-

siteti i Shkodrës ka blerë një automjet në vlerën 24.000 euro.

**Cili universitet ka shpenzuar më shumë para dhe a janë konstatuar afëra korruptive nga drejtuesit?**

Universiteti Politeknik i Tiranës, është universiteti që ka shpenzuar më shumë para për këtë periudhë monitorimi me 2.9 milionë euro, ndjekur nga UAMD me 2.8 milionë euro. Organet që mund të konstatojnë nëse ka korrupsion apo jo janë policia dhe prokuroria, por ne shpresojmë që këto gjetje t'u shërbejnë institucioneve, por edhe studentëve për të kërkuar llogari tek drejtuesit e universiteteve për paratë që ata paguajnë.

**Sa para janë investuar për kërkim shkencor apo studime të tjera?**

Një ndër kërkesat kryesore të protestës ishte pasurimi i bibliotekave të universiteteve, nga shpenzimet e tyre në thesar vërehet se 3 prej universiteteve kanë shpenzuar 0 lekë për blerje librash, ndërsa 5 nga 7 universitete kanë shpenzuar 0 lekë për studime dhe kërkime.

**Shoqëria perparimore JUSTITIA**  
 Shoqëria perparimore JUSTITIA shpall ankandin, faza e tretë, për shitjen e pasurisë së palajshme për të cilën ka venë hipoteke BKT BANK, me këto të dhëna:  
 Pasuria "ARE" nr. 1775, Zona Kadestrale 3339, me sipërfaqe 7780 m<sup>2</sup> faqe 190 vol.5, e ndodhur në Vrin Durrës, në pronësi të z.Adrian Selzer Kapllani dt.08.03.1969, z.Merita Myzaler Kapllani dt.24.06.1970.  
**Në vlerën 7.308.000 (shtatë milion e treqind e tetë mijë ) Lekë.**  
 Pasuria Apartament me sip.120m<sup>2</sup> nr.pas.41/150+1-1 z.k.8518 vol.116 fq.54 me adresë:Plazh /13 Durrës në pronësi të z.Adrian Selzer Kapllani dt.08.03.1969.  
 Në vlerën 3.390.569 ( tre milion e treqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntës ) lekë.  
 Ankand i zhvillohet në datën 20.05.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbaruesit gjyqësor me adresë Bulevardi' Bajram Curri', Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë.

**SHPALLJE ANKANDI**  
 Zyra Perbarimore "E.G Ballif Service" me Përbarues Gjyqësor Enuar Merko me adresë, Rruga' Ibrahim Rugova', Pallati 64, Hyrja 8, Apartamenti 1, Tiranë, njofton se më datë 17.05.2019 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankand i III - të për shitjen e pasurisë së palajshme, Apartament me numër pasurie Nr.5/264+ND+1-2, Zona Kadestrale 8250, Volumi 20, Faqe 118, me sipërfaqe 137 m<sup>2</sup>, ndodhur në adresën, Bulevardi 'Zhan D'Ark', Tiranë, pronësi Z.Bujar Musa Kajtazi, me vlerë fillestare në ankand 62'294.4 (Gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind e nëntëdhjetë e katër mijë pikë katër) EURO.  
 Të interesuarit të kontaktojnë në nr.e telefonit 0672027580, + 355 4 22 31 888, email enuar.merko@gmail.com;

**SHPALLJE ANKANDI**  
 Zyra Perbarimore "E.G Ballif Service" me Përbarues Gjyqësor Enuar Merko me adresë, Rruga' Ibrahim Rugova', Pallati 64, Hyrja 8, Apartamenti 1, Tiranë, njofton se më datë 03.05.2019 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankand i I - të për shitjen e pasurisë së palajshme, Ttuall me sipërfaqe totale 3104 m<sup>2</sup>, regjistruar në Z.V.R.P.P Durrës, me Nr.pasurie 16/131, Volumi 11, Faqe 10, Zona Kadestrale 8516, në pronësi të Shoqërisë "ADRIATKA BETON" sh.p.k, me vlerë fillestare në ankand 322.816 (Treqind e njëzet e dy mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë) Euro.  
 Të interesuarit të kontaktojnë në nr.e telefonit 0672027580, + 355 4 22 31 888, email enuar.merko

Kreu i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës: Hartë të re për pronat në të gjithë vendin

# Lame: Janë 80 mijë leje legalizimi të paregjistruara

## Tokat në bregdet, ja si të kryhet regjistrimi

**R**reth 80 mijë leje të dhëna nga Agjencia e Legalizimeve ndër vite nuk janë regjistruar në sistemin e Hipotekës. Këto leje të dhëna, por të paregjistruara, do të kalohen në një pjesë të veçantë të sistemit për të mos kufizuar qytetarët nga e drejta e tyre mbi pronësinë. Harta e pronave për të gjithë vendin do të ndërtohet nga e para dhe si bazë do të shërbejë harta e ALUIZNI-t, e cila është më e sakta dhe e përditësuar. Ndërkohë, regjistrimi i tokave në bregdet do të nisë së shpejti. Pronarëve do t'u lihet një afat i arsyeshëm kohor për të depozituar dokumentet e pronësisë që disponojnë, më pas do të vijojë regjistrimi i tyre. Detajet janë bërë të ditura dje nga kreu i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës e sapokrijuar nga shkrija e ALUIZNI-t dhe ZRPP, Artan Lame, gjatë një takimi informal me gazetarët. Lame sqaroi mënyrën sesi do funksionojë institucioni i ri. Ai theksoi se institucioni i krijuar mbi bazë të ligjit "Për kadastrën" pritet të zgjidhë një herë e mirë pjesën e përgjithshme institucionale që ka frenuar avancimin e projektit".

**KADASTRA**

Krijimi i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës ka për synim t'i japë zgjidhje përfundimtare çështjes 25-vjeçare të pronave në Shqipëri. Struktura e re pritet të bëjë të mundur regjistrimin dhe inventarizimin e të gjithë pronave, zgjidhjen e çështjes së mbivendosjeve, mbylljen e procesit të kompensimit të ish-pronave dhe përfundimin e të gjithë procesit të legalizimit. Kreu i Agjencisë Shtetërore të Ka-



Kreu i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Artan Lame

dastrës, Artan Lame, mbledhi dje në një tryezë gazetarët e ekonomisë, ku përveç evidentimit të gjithë problematikave kryesisht në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Lame bëri të ditur edhe planin e punës që do të ndjekë struktura e re për zgjidhjen e çështjes së pronave.

**HARTAT DHE TOKAT NË BREGDET**

Agjencia Shtetërore e

Kadastrës do të ribëjë të gjitha hartat. "Do të ribëhen të gjitha hartat, por nuk do të ketë dalje në terren", - tha Lame. Kreu i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës bëri me dije se do të nisë regjistrim masiv në jug për tokat në bregdet. "Do të ndiqet procedura standarde e shpalljes së njoftimit, të silltet dokumentacioni, të mbledhin të dhënat, të bëhet rivlerimi dhe do të hidhen në

**Ligji i ri për pronat**  
 Ligji i ri për Kadastrën sjell shkriren në një institucion të vetëm të Agjencisë së Legalizimeve dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Ndër të tjera, ligji përcakton edhe hapat që duhet të ndiqen për korrigjimin e gabimeve në të dhënat kadastrale. Referuar ligjit të ri, gabimet që vijnë nga veprimtaria e drejtorisë vendore korrigjohen pas konstatimit që bën drejtori vendor ose drejtori i përgjithshëm kryesisht, struktura përgjegjëse për ankimet ose me kërkesë të personave të interesuar. Drejtoria kadastrale është e detyruar të korrigjojë gabimet në pasqyrimin e të dhënave në kartelë dhe në hartën kadastrale, në raport me dokumentacionin e pronësisë, apo me gjendjen faktike të pasurisë.

sistem ato prona me tituj të saktë nga ana formale. Pra, kush ka një akt pronësie të ligjshme, regjistrohet", - nënvizoi Lame.

**LEGALIZIMET**

Janë 80 mijë leje legalizimi të dhëna nga Agjencia e Legalizimeve ndër vite, që nuk janë regjistruar në sistemin e Hipotekës. Artan Lame gjatë një takimi me mediat sqaroi mënyrën sesi do të funksionojë institucioni i ri. Sipas Lames, synimi është që këto leje të dhëna, por të paregjistruara, të kalohen në një pjesë të veçantë të sistemit për të mos kufizuar qytetarët nga e drejta e tyre mbi pronësinë. Lame shpjegoi se ligji përcakton që ZRPP-ja të jetë institucioni që mbetet si bosh kryesor, kurse ALUIZNI i bashkëngjitet. "Fillimisht do të jenë 41 zyra, ndërsa synohet që të shkohet në 61 bashki për të pasur një në çdo

bashki. Në çdo zyrë ka një regjistruar që do të kthehet në drejtor vendor i kadastrës dhe ai mbulon regjistrimin e pasurive dhe proceset kalimtare", tha kreu i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Lame.

**PUNA NË TERREN**

Lame nënvizoi faktin se në terren ka nevojë për disa sipërmarrje të rëndësishme, duke nisur nga skanimi dhe dixhitalizimi dhe për t'i qëndruar në një sistem. "Po bëjmë shkriren e institucioneve, i emëruar jam vetëm unë. Struktura duhet të miratohet nga kryeministri dhe më pas nis riemërimi nga lartë poshtë. Për hipotekën ka pasur në 20 vite 120 milionë euro shpenzime, që kanë prodhuar një sistem hartografik të gabuar që do bëhet nga e para. Sot nga 170 mijë leje të dhëna, rreth 80 mijë janë të paregjistruara", tha Lame.

**MARREVESHJA**



**Drejtori i ri/ Aviacioni Civil, Shqipëria bie dakord me Kosovën për shkëmbim eksperiencash**

Drejtori i Autoritetit të Aviacionit Civil, Krislen Keri, ka pritur në një takim drejtorin e ri të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, Esat Berisha. Referuar njoftimit zyrtar, Keri i uroi sukses zotit Berisha për emërimin në këtë detyrë të rëndësishme. Më tej, dy zyrtarët diskutuan për sfidat e përbashkëta që kanë autoritetet respektive dhe mundësinë e bashkëpunimit në të ardhmen. "Një mundësi bashkëpunimi që palët ranë dakord se duhet të jetë më intensive është shkëmbimi i eksperiencave në disa fusha të aviacionit. Drejtori Berisha kërkoi që në të ardhmen, punonjës së AAC-së së Kosovës të marrin pjesë në aktivitetet e shumta që Autoriteti i Aviacionit Civil shqiptar zhvillon në bashkëpunim me organizatat partnere ndërkombëtare, për të cilat ka marrë edhe vlerësime të larta", shkruhet në njoftim. Keri dhe Berisha u angazhuan për vijimin e takimeve periodike mes 2 autoriteteve në kuadër edhe të ECAA, si dhe mundësinë e përmirësimit të marrëveshjes së bashkëpunimit midis dy autoriteteve.

## Gazsjellësi TAP, 44.8 mln lekë për shpronësimin e pronarëve që preken nga projekti

**M**inistria e Infrastruktura dhe Energjisë ka shpallur zyrtarisht kërkesën për shpronësimin e pronarëve që preken nga punimet për testimin e tubacionit të gazsjellësi Trans Adriatik. Vlera totale paraprake e shpronësimeve kap shifrën e 48 870 348 49 lekë. Referuar kërkesës së publikuar në Fletoren Zyrtare, bëhet fjalë për marrjen në përdorim të pronës private për periudhën 6-mujore, 1-vjeçare, 1 vit e 6 muaj si dhe 2-vjeçare si dhe shpronësimin e vendosjes e gazsjellësit Trans Adriatik mbi pronat private, që preken nga punimet për testimin me ujë të tubacionit si dhe përfundimin e punimeve. Kështu, personat e



prekur nga ky shpronësim do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të përlogarit me ligjin e posaçëm nr. 116/2013. Ata të cilët e kanë emrin në listat e mëposhtme si dhe personat që preken, por nuk figurojnë në këto lista, brenda 15 ditëve nga plotësi-

mi i këtij afati për publikim kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentacionin përkatës. Dorëzimi duhet të bëhet pranë ZVRPP-së përkatëse për saktësimin dhe konfirmimin e pronësisë, sipërfaqeve, etj.

United Nations Development Programme

**TENDER ANNOUNCEMENT**

**Subject:** Request for Proposal for "RFP for Technical assistance to Ministry of Finance and Economy on Employment and VET policy reform".

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive proposals from interested companies who wish to be considered for the above-mentioned service.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The proposal must be delivered within the deadline set in a sealed envelope, clearly marked **UNDP/RFP/2019-54717 "RFP for Technical assistance to Ministry of Finance and Economy on Employment and VET policy reform"**.

**For more details, please refer to the link below:**  
[http://procurement-notices.undp.org/view\\_notice.cfm?notice\\_id=54717](http://procurement-notices.undp.org/view_notice.cfm?notice_id=54717)

**Relevant dates:** All interested entities should provide their proposal, not later than **24 April 2019, 14.30 hrs.**, to the address:

**United Nations Development Programme**  
 "Skenderbej" Street, Gurken Center, 2nd Floor,  
 Tirana, Albania  
 UNDP Procurement team



NIMETE IBRAHIM		SANIE	DERHEMI	RAMAZAN		LIRI RISTA		LUAN MEHDI
HASEKIU		MAKBULE	DERHEMI	BOGDANI		NATASHA	DEMIRI	SHPRESA ANASTAS
MANUSHAQE	RIFAT	EDLIRA	METANI	RESHAT		ATHINAJA	NDINI	ALI XHEVDET
BUMCI		LINDITA	BALLA	SAMIR KADRI	BOGDANI	VASILIKA	MALAJ	ISMAIL XHEVDET
ENGJELLUSHE	RIFAT	(MET'AND)		ENIDA	BOGDANI	NATASHA	PETANI	MEHMET XHEVDET
BUMCI		NAILE	METANI	ELDA RAKIP	BOGDANI	KLAUDIA	PETANI	PLATON XHEVDET
FATBARDHA	RIFAT	(DERHEMI)		ELVIAGRON	BOGDANI	ERVIS	PETANI	RUKIJE XHEVDET
BUMCI		ZAMIRA		ATLJE	YLLI	VASILLAQ	DHAMO	ZYRA XHEVDET
GAZMEND	PETRIT	KLEMENDI(DERHEMI)		BILAL	BOGDANI	SEDAT	LIBOHOVA	AIDA FEJZULLA
HASEKIU		ARJAN	DERHEMI	DIANA BEQIR	BIBA	SOFIE	GJKA	AIDA URAN
IBRAHIM PETRIT	HASEKIU	INDRIT	DERHEMI	FATMIR	BOGDANI	PJERETA	ÇIKA	EMINE XHEVDET
ANDREA PETRIT	HASEKIU	EVA TOCI (DERHEMI)		RAMAZAN		REFAT	FRASHERI	FATIME XHAFERR
EDUART MUSA	DUHANXHI	KUDRETE	ELBASANI	BOGDANI		SHOQERIA RDA	PETROL SHA	FEJZULLA URAN
IRMA	HAJRULLA MURATI	IRMA	SHEHAJ	RESHAT	BOGDANI	HATIXHE ALI	KRAJA	AGRON XHEVDET
MEHMET HYSEN	SHIJAKU	MALIQ MAHMUT	TAFATA	SAMIR KADRI	BIBA	YMER	XHAFERKRAJA	ALI XHEVDET
MERDIJE KAMBER	DUHANXHI	ALBANA SELFO	DEMI	DESHIRA	GREVA	QEMAL	XHAFERKRAJA	GJYSTINA FEJZULLA
SHEFQET KAMBER	DUHANXHI	ARMANDO	SELFO	HAJDAR	ZELA	BAHRI	XHAFERKRAJA	ISMAIL XHEVDET
SHPRESA MUSA	DUHANXHI	MOSHO		QEFSERE	RUSHEKU	BEQIR	XHAFERKRAJA	ISUF XHEVDET
BURBUQE HYSEN	XHEPA	BARDHYL	MUMAJESI	VJOLLCA	VOKSHI	ENVER	XHAFERKRAJA	MARLENA FEJZULLA
QAZIM MUSA	DUHANXHI	MAKSIM	MUMAJESI	XHEVRIJE	KATROSHI	HAVA	XHAFERKRAJA	MEHMET XHEVDET
HYSEN VELI	GJATA	MUBAREQ	MUMAJESI	ADILE	JAHO	HAMIDIJE	XHAFER	MELEQE XHEVDET
ISUF KAMBER	DUHANXHI	BAJRAM	MUMAJESI	AGIM	JAHO	KRAJA		MIT'AT XHEVDET
AGRON TEKI	TELA	NAILE	MUMAJESI	EDMOND	JAHO	DRITAN	MUHAMET KRAJA	PLATON XHEVDET
ANITA MASAR	ALICKA	MIRJAN	MUMAJESI	FATMIRA	DYRMYSHI	FATJON	MUHAMET KRAJA	RUKIJE XHEVDET
BULENT TEKI	TELA	MILUKA	MUMAJESI	(JAHO)		AFERDITA	MUHAMET	VJOLLCA XHEVDET
EDMOND TEKI	TELA	EDMOND	MUMAJESI	GEZIM	JAHO	KRAJA		ZYHRA XHEVDET
FELATON MAZLEM		ELVIJE	VOGLI	INDRIT	JAHO	FATIME	XHAFERKRAJA	DRITA FEJZULLA
KARAIKAJ		BASHKIM	ARBANA	MUHazes	JAHO	NUSRET	SAIT	HAJRIE FEJZULLA
GJERAK MAZLEM		ISLAM	ARBANA	NEXHMIJE	JAHO	AISHE	GURRA	NIKOLL DOD
KARAIKAJ		KRYEGHYSHATA	BOTERORE	MIMI	JAHO	AGIM	GURRA	NIKOLL DOD
HAJALI ISMAIL	YPI	BEKTASHIANE		AGRON	SKENDERI	EQEREM	GURRA	LAJE
LAVDIJE	SKENDER KALASA	KRYEGJYSHATA	BOTERORE	BASHKIM	PINARI V.	MELIHA	GURRA	IBAHIM
NEBI ISMAIL	SEFA	BEKTASHIANE		BASHKIM	KACA	GENC	GURRA	BUKURRIJE
NESFIJE	TEKI	ALDA	TOPTANI	EDMOND	MEMA	DIANA	FASLLI	PETRIT
SELENICA(TELA)		ARDIAN	TOPTANI	JALLDIZ	MEMA	FLORIAN	FASLLI	MYZEJEN
SHAZIVAR	MASAR	FADIL	TOPTANI	LULZIM	KACA	FATBARDHA	ABEDIN	BEXHET
KAROSMANI		LUMTURI	TOPTANI	RITA	MEMA	VERA	BAJRAM	IKBALE
SHEGUSHMASAR	KOSOVA	MYNEVERE	TOPTANI	YLLI	MEMA	DORIAN	NESTOR	GENTIAN
TEUTA SKENDER		VERA	TOPTANI	MURAT	IHSAN	ARIANA	NESTOR	EQEREM
XHANETA	ISMAIL	XHULI	TOPTANI	SILVANA	IHSAN	RREZAR	SAMIR DILAVER	GEZIM
PRODANI		REFIK	HAXHI	TAULANT	IHSAN	URAN	DILAVER	ILJONKA
HENRIETA KADRI	KUNGULLI	BARDHYL	ABAZI	XHEVDET	QAZIM	ZANA	ARIF	ADRIANA
OMER AZMI	STRINGA	FATIME	DEDJA	BRIGITA	XHEPA	ANRI	ADMAND	JETMIR
ARBEN AGRON	STRINGA	HATIXHE	BALLA	KURT	QAZIM	ASTRIT		ALDO
ERVIN MUSTAFA		HAZIZ	ABAZI	ARIANA	PILIKA	MYZEJEN	ALI	FATMIR IBRAHIM
LAMCJA		KAJE	MUMAJESI	TAKUINA	ADAMI	EDUART	BEHAR	QAZIM ALI
GLADIOLA	AGRON	KUMERI	BALLA	ARIANA	PILIKA	ERVIS	BEHAR	HALIT JAKUP
STRINGA(DAKLI)		MALIQ	ABAZI	TAKUINA	ADAMI	ZYBER	KAMBER	LUAN SKENDER
LUMNIE ZIJA		MUHARREM	ABAZI	ISMAIL ALI	ALI	DION	ALI	YMER SKENDER
LUNIKU(MUÇA)		MUSA	ABAZI	ISMAIL ALI	ALI	AGIM	SABRI	NAMIK SKENDER
MERITA MUSTAFA		OSMAN	ABAZI	DHURATA	KALTANI	MYZAFERE	QENAN	RUZHDI JUSUF
LAMCJA(DURO)		RAZIJE	RAUFI	HADIJE	OSMANI	TAHIR	ARIF	RESHAT JUSUF
PRANVERA	AZMI	SHEQERE	ABAZI	ISMETE	KALTANI	ATLIJE		IZETJUSUF
HAMZAJ(STRINGA)		SHERIFE	ABAZI	ALMA	GJELI	DIANA	BEQIR	GJYLAFERE SELIM
VJOLLCA ZIJA	LUNIKU	VELI	ABAZI	BUJAR	OSMANI	ELDA	RAKIP	GEZIM XHEVAT
LILJANA MUSTAFA		XHARIJE	ABAZI	BURBUQE	ARUCI	ELVIAGRON		MELEQE XHEVAT
LAMCJA(BIÇOKU)		XHEMILE	ABAZI	ELMIRA	HAJDARI	ENIDA		ASTRIT XHEVAT
BENON MUSTAFA		HAXHIRE	BAKALLI	MUHAMED	OS-	FATMIR		
LAMCJA		EDUART	SALI	MANI		RAMAZAN		ROZINA MARK
BRIKENA SEZAI		GANI	ABDULLA	HEKTOR	OSMANI	RESHAT		BENET KOLE
HAXHIADEMI(BAXHAKU)		MERITA	SALI	HELIDON	OSMANI	SAMIR	KADRI	FERDINAND
ALEMSHA	AZMI	RAMAZAN	ABDULLA	NADIRE	OSMANI	EUGEN	BILAL	FILIP LUIGJ
BOLLANO(STRINGA)		BELIU		ALMA	GJELI	ELIONA	BILAL	FRANÇESKINA LUIGJ
SHQIPONJA	AGRON KUSI	DIANA	ESAT	BUJAR	OSMANI	LEJLA	HYSEN	HELIDON KOLE
DANJELA DURIM	KUSI	ZHAKLIN	ESAT	BURBUQE	ARUCI			LUIGJINA JAKE
GEZIM DURIM	KUSI	ZHENI	ARBEN	ELMIRA	HAJDARI	AFERDITA		NATALE LUIGJ
KEJSI DURMI	KUSI	LEIF	ABDULLA	MUHAMED	OSMANI	ARJETA		ROLAND MARK
PULLUMB	QOSJA	MYZEJEN	ABDULLAKAZAZI	HEKTOR	OSMANI	AVENIR		DRANDE GJELOSH
HAMIDE	RUSHEKU	ADNAN	DIBRA	HELIDON	OSMANI	BARDHYL		RREGJINA FILIP
NADIRE	MYSLYM	ARTAN	DIBRA	NADIRE	OSMANI	FLUTURA		ALBINA FILIP
KELLEZI		ASTRIT	TOPTANI	FONDI	BESA SH.A	HALIL		ROZINA FILIP
AGIM	EMIN	BIBIKA	STAROVA	ERALD	BERHOMI	KLEJDA		JOLANDA FILIP
ILIR EMIN	MUCA	BONIN	TOPTANI	AISHE	ARAPI	LIRI		BEPIN FILIP
LUCIE	DOMA	DASHURI	DIBRA	BURHAN	ARAPI	LULEZIM		IZABELA FILIP
REXHEP	DOMA	DRITA	BOBRATI	DHURATA	ARAPI	NADIRE		FERDINAND FILIP
SABRIJE	DOMA	ELDA	KONOMI	KADRI	ARAPI	SADETE		ABRAHIM
KOMUNITETI	MYSLYMAN	ELISABETA	TOPTANI	LEJLA	ARAPI	SOKOL		GJYLASFJE
BUKURIE	KOKONOZI	FUAT	LIBOHOVA	SAMIR	ARAPI	VERA		MUHAMET
SULEJMAN		GAZMEND	DIBRA	LEFTERI	SHKURTI	VJOLLCA		QAMILE
KOKONOZI		GENCI	DIBRA	EVALDA	CHIARELLA	REXHEP		SYRRIJE
MEHEMT	ILJAZI	HIRMA	DIBRA	EVALDA	CHIARELLA	LUTFI	HAMZA	XHEMILE
SULEJMAN	ILJAZI	ILIR	DIBRA	EVALDA	CHIARELLA	VIKTOR	MNATHO	XHEVAHIRE
KRYEGJYSHATA	BOTERORE	KADRI	LIBOHOVA	EVALDA	CHIARELLA	VASIL	SPIRO	MARIJE
BEKTASHIANE		LIMANE	ORGOCKA	EVALDA	CHIARELLA	BAHIR		ÇEÇILJANA
YY ALBANIA	DEVELOPLTD	LUAN	DIBRA	EVALDA	CHIARELLA	FATOS		JUSTEREZA
CONSTRUKSION		LULZIM	TOPTANI	EVALDA	CHIARELLA	NINFA		NIKOLIN
LINDITA	DUSHMANI	MELI	KELLCI	EVALDA	CHIARELLA	PRANVERA		AFERDITA
ZHULIETA	BESIM	NASIBE	QOSE	EVALDA	CHIARELLA	MAKSIM		HALIT
MUHAMET	ISMAIL	NERMIN	DIZDARI	EVALDA	CHIARELLA	PERPARIM	ALIM	IXHLELE HALIT
SHPATI		RAHMI	QORALIU	EVALDA	CHIARELLA	FATO		JANA NASI
ARBEN	BESIM	TEFTA	BABAMETO	EVALDA	CHIARELLA	MIRJETA	ALIM	VITMIRA KUJTIM
OSMAN	HYSEN	VERA	HAKIU	EVALDA	CHIARELLA	FJONA	FATOS	BLERIM KUJTIM
SKENDER	ISMAIL	XHIMI	DIBRA	EVALDA	CHIARELLA	SILVANA	ALIM	ALBANA HAZIZ
KUJTIM	ISMAIL	ESAT	FEVRI	EVALDA	CHIARELLA	ZAMIRA	ALIM	BUJAR RIFAT
QEFSERE	ISMAIL	VIOLETA	FEVRI	EVALDA	CHIARELLA	FITNETE		DRITA HAJREDIN
PETRIT	ISMAIL	(PAZARI)		SABRI	SHALA	AFRIM		FATIME HAJREDIN
VJOLLCA	ISMAIL	KOMUNITETI	MYSLIMAN	MERITA	JAVER	DASHAMIR		FLORINDA HAZIZ
FATMIRE	ISMAIL	ATLIJE	YLLI	SABRI	MYSLIM	TEFERI		GEZIME HAZIZ
HYSEN	OSMAN	BILAL	BOGDANI	MERITA	JAVER	MARJANA		HAJREDIN RIFAT
DURIM	OSMAN	DIANA	BEQIR	SABRI	MYSLIM	FITNETE		KAPLLAN HAJREDIN LIRIJE
ALMA	OSMAN	ELDA	RAKIP	URFIRUZHDI	AGOLLI	AFRIM		
BRIKENA	OSMAN	ELVIAGRON	BOGDANI	BERNARD	CAUSHAJ	DASHAMIR		MAJLINDA HAZIZ
HAXHI	DERHEMI	ENIDA	BOGDANI	EDUARD	CAUSHAJ	TEFERI		SKENDER RIFAT
HASAN	DERHEMI	FATMIR	BOGDANI	YLLKA	TALO	MARJANA		ZEMRIJE HAJREDIN

# VIP

Suplement  
Pages

E mërkurë 17 Prill 2019

GAZETA SHQIPTARE

Redaktore: Pamela Aliaj

## "BULEVARDI POLITIK"

- Tre deputetët socialistë që u trishtuan më shumë për Notre Dame de Paris
- Zhurma e shashkave dhe thirrjet e protestuesve shqetësojnë ish-deputetët e opozitës
- Mihail Gorbaçov, kandidati më i ri në parlamentin indonezian
- Lindja e fëmijës së parë, vendimi personal i Meghan Markle...


Ledri i dashuruar? Ja vajza që i ka rrëmbyer zemrën dhe detajet që e dëshmojnë këtë



Modelja seksi spanjolle viziton "Prestige Resort": Mezi po pres



Sërish pjesë e "Vogue", flet fotografi: Këtë verë po diskutoj me modelë e grimierë të famshëm



## Sirio Berati: Së shpejti në Shqipëri, ja projektet surprizë

*"Sjell në jetë koncepte, që vështirë të konceptohen apo realizohen në përditshmëri"*

Sërish pjesë e "Vogue", flet fotografi: Këtë verë po diskutoj me modelë e grimierë të famshëm

# Sirio Berati:

## Së shpejti në Shqipëri, ja projektet surprizë

"Sjell në jetë koncepte, që vështirë të konceptohen apo realizohen në përditshmëri"

Pamela Aliaj

Janë të paktë shqiptarët që arrijn të identifikohen me talentin e pasionin e tyre në botë. Po aq të paktë janë edhe ata që arrijnë me shumë punë e përpjekje ta mbajnë gjallë e të bëhen dikushi falë pikërisht këtij talenti. Një ndër ta, edhe pse në moshë shumë të re është fotografi, ose më saktë artisti vizual/dixhital, Sirio Berati. Në një intervistë për "Vip Pages" të "Gazeta Shqiptare", ai na rrëfen si lindi pasioni për foton dhe artin si dhe vështirësitë që ka kaluar për të arritur në hapat që është tani. I preferuar për punën edhe nga "Vogue Italia", Sirio ka një vizion të afërt për fotografinë dhe projektet që dëshiron t'i jetëzohë në Shqipëri, duke sjellë frymën ndërkombëtare. Për më tepër në intervistën e mëposhtme:

**Jeni një ndër fotografat më të vlerësuar për stilin e punës suaj si dhe imagjinatën që kenë. Si lindi dëshira për të zgjedhur këtë rrugë?**

Kam dashur gjithmonë të sjell diçka ndryshe dhe jam frymëzuar nga miqtë e mi të huaj në artin tim. Gjithmonë kam dashur të shkoj përtej fotografisë dhe të krijoj botën time. Të realizoj koncepte që janë vështirë për t'u konceptuar apo realizuar në jetën e përditshme. Unë nuk jam fotograf. Do e quaja më shumë veten një artist vizual/dixhital.

**Jetoni prej kohësh jashtë Shqipërisë. Ju zgjodhi Kanadaja ju, apo ju atë?**

Më zgjodhi ajo mua. Isha në një periudhë shumë të vështirë për zgjedhjen e degës dhe universiteteve. Unë studioja në Angli. Për mendimin tim, universitetet atje lëjnë shumë për të dëshiruar, janë më shumë biznes për në studentët internacionale. Nuk të japin mundësi, edhe pse unë dola me rezultate shumë të larta. Mjafton një refuzim nga një universitet prestigjioz që të refuzohesh të të gjithë të tjerët. Punë e interes. Aplikova më pas në Kanada, në universitetin nr.1, McGill dhe më pranuan, madje më dhanë mundësinë të hidhesha direkt viti i dytë. Për më tepër, pagesa është shumë herë më e konsiderueshme se sa në Angli.

**Para pak kohësh kenë prezantuar galerinë tuaj të punimeve në Ambigu. Si u prit dhe çfarë stili zotëronte në punimet tuaja?**



Unë solla sërisht në Ambigu ekspozitën që kam mbajtur në Angli, veç me më pak vepra. Ekspozita ime quhet "Afrohuni Kaosit". Temat kryesore që paraqiten janë identiteti dhe kultura. Stili po surreal/fantazi. Një ekspozitë me medime të ndryshme, nga piktura me akrilik, skulptura, video, fotografi e vizatime. Në Ambigu prezantova vetëm artin tim dixhital dhe të them të drejtën u prit shumë mirë, si nga shqiptarët e Montrealit, gjithashtu edhe të huajt.

**Një ndër eksperiencat më të përfolura ka qenë ajo me "Vogue Italia". Si erdhi propozimi? A do të ketë bashkëpunime të tjera?**

Kanë qenë foto të miat personale, që i kam dërguar në portalin e tyre dhe nga selektimi i disa prej tyre, editoriali pranoi disa portrete. Kam shumë material që po mendoj ta vendos në "Vogue". Jam duke diskutuar me disa modele dhe grimierë për konceptin mbroptë. Do pak kohë realizimi, sidomos tani në verë.

**Kush, apo çfarë ju ka frymëzuar që të kenë një stil të tillë në punët tuaja?**

Muzika dark (e errët), filmat thriller dhe filozofia. Nuk e di, por në momentin kur shoh realizime kinematografike të tilla, ndikohem në konceptimin e ngjyrave dhe ideve. Filmat thriller/horror mbahen për

narrativën dhe fantazinë. Deri diku më kanë influencuar. Më pas njohja me filozofinë dhe me disa artistë i ka dhënë një rafinim të mëtejshëm stilit tim. Jam akoma në gjetjen e vetes. Nuk e di akoma se ç'dua të bëj.

**Me çfarë po merret tani Sirio? Keni ndonjë projekt të afërt me ndonjë figurë të njohur në Kanada?**

Jam duke konceptuar ide. Po, kam disa projekte me disa njerëz të njohur këtu në Kanada. Gjithashtu, kam një bashkëpunim me "Goss Magazine" si kryeeditor dhe me një dizainer. Unë nuk kam shumë që jam shpërngulur në Kanada. Duhet akoma punë për më tej, por shoh që ka pafund mundësi.

**Në një intervistë të mëparshme kenë thënë se do bëni së shpejti një "fotoshooting" në Kanada në linjat e "Meet Gala". Kur do të zhvillohet dhe kush artistë të njohur do të jenë pjesë e punës suaj?**

"Fotoshooting" e kam menduar të bëhet në kuadrin e dërgimit të fotove në "Photo-Vogue" dhe disa revistave të njohura këtu si "Flanelle", "Le Fronte" etj. Do të zhvillohet këtu dhe me modelë vendës. Në të kundërt, kam disa ide se me kë mund t'i zhvilloj në Shqipëri, por nuk mund të zbuloj surprizën për momentin.

**A kenë pasur ndonjë propozim nga ndonjë personazh i njohur VIP?**



**Stilin e kujt parapëlqeni më tepër që do të preferonit të punonit?**

Ka pafund artistë shqiptarë që mund të doja një bashkëpunim, sidomos me fotografë të rinj, njerëz me ide, që mund të identifikohem lehtësisht. Andi Deçani, Ilian Stërmolli e shumë të tjerë. Për sa u përket personazheve, preferoj të bashkëpunoj me njerëz që kanë guxim të sjellin diçka të re. Njerëz që e vlerësojnë një artist, një fotograf dhe nuk e shikojnë thjesht si një individ, që duhet të japë një produkt sepse po paguhet dhe jo për të sjellë diçka të tillë. Marrëdhënia fotograf-model është shumë e rëndësishme. Madje s'do të thosha fotograf-model, por bashkëpunim midis dy artistëve. Zakonisht fotografat janë të nënshtruarit e personazheve VIP, duke u krijuar një formë hierarkie. Unë nuk mund të bashkëpunoj dot me dikë që krijon hierarki. Së fundmi kam bërë një bashkëpunim me Megi Pojanin. Absolutisht një njeri mendjehapur, që di të vlerësojë artin, di të kontribuojë në ide, di të komunikojë dhe guxojë, di të kritikojë dhe për më tepër, di të bëhet njësh me fotografin dhe tematikën. Një nga "photoshootet" e vetme të mia ku pragu klasik, fotohtësia, inferioriteti, linja që respektohet me rigorozitet midis fotografit me modelin, në sensin e hierarkisë që vendos në presion fotografin është zhdukur. Eksperiencë vërtet shumë produktive. Nëse do të bëja bashkëpunim me dikë tjetër, do të kërkoja pikërisht njerëz të tillë dhe janë shumë të pak-të.

**Sirio studion për drejtësi, por pasioni është fotografia. Ku e shihni veten më tepër në të ardhmen?**

Gënjeh nëse them që e di. I dua që të dyja, por mendoj se nuk ka më bukur se të identifikohesh si artist, të jesh artist. Politikanin dhe avokatin të gjithë e bëjnë. Unë jam shpirt i lirë. Do të doja shumë të kisha një karrierë si artist, gjithmonë pjesë e

industrive të mëdha.


**Sa e vështirë është të jesh një fotograf i huaj në Montreal të Kanadasë? Kush ka qenë mbështetësi tuaj më i madh në pasionin tuaj?**

Varet se çfarë fotograf. Unë e zhvilloj si pasion, nuk mund të them dot, por di që deri tani dyert më janë hapur. Është akoma shumë shpejt. Suporti më i madh janë prindërit, si gjithmonë. Në çdo hap dalin garant dhe janë aty për mua. Më pas miqtë e mi të ngushtë dhe sigurisht, njerëz të që më mbështesin çdo ditë në rrjetet sociale.

**Së fundmi jeni duke u marrë me punimet tuaja në "Youtube" dhe me artin vizual. Si është e bukura e perceptuar në sytë e Sirios?**


Unë kam dashur gjithmonë të krijoj një "network" në Shqipëri për fotografinë, duke qenë se nuk ka akoma. Askush deri tani nuk është munduar të jetë aty për pjesën tjetër që kërkon të dijë dhe të mësojë për fotografinë. Unë dua të ndaj me këdo të interesuar eksperiencat e mia, mendësinë time, idetë e mija dhe aftësitë e mija. Shqiptarët kanë nevojë dhe janë të gatshëm të mësojnë diçka të re, edhe pse unë kam qenë pak dyshues në fillim. E bukura për mua është diçka që fsheh jo tregon. Në momentin kur dikush është konfuz dhe nuk e kupton menjëherë idenë pas një punimi, tregon që ai punim ka në brendësi shumë mendime kritike, që nuk janë të thjeshta për të dalë në sipërfaqe. Unë inspirohem nga artistët që janë të thjeshtë dhe pas thjeshtësisë së artit të tyre gendjet gjysma e fshehur e ajbsgerit, dhe pse artit im deri diku në pamje të parë duket i komplikuar. Shumica e punimeve të mia kanë pasur ide. Nuk janë aty vetëm sepse duken bukur. Një vepër e bukur për mua është një vepër që ka kuptim, një vepër që të lë mbresë dhe të bën të jesh kurioz për më shumë.

**D**eri para pak kohësh e njohim thjesht si një këngëtare dhe s'dinim asgjë për shkollimin e saj. Ndërkohë që së fundmi zbuluam se Adelina Tahiri qenka super e shkolluar! Këngëtarja u ka rrëfyer ndjekësve të saj se është e diplomuar në universitet për herë të parë. Dikush nga fansat e pyeti në seksionin e pyetjeve përgjigjeve në "Instagram" se çfarë bagazhi akademik ka. Dhe Adelina e dëshmoi se ka dy diploma universitare duke i xhiruar ato në "Instagram", ndërsa për tjetrën tha se e kishte në shtëpi. Megjithatë, ajo nuk rrefeu se çfarë shkollimi ka përfunduar!



**S'do ta besoni! Këngëtarja shqiptare ka 2 diploma bachelor dhe 1 master**

**J**avën e kaluar këngëtarja e njohur, Ledri Vula, ishte në qendër të lajmeve të "showbiz"-it për shkak se u shpreh në një intervistë që ishte gati të bëhej baba dhe t'i përkushtohej familjes. Shumë prej ndjekësve të tij u habitën për këtë dëshirë të Ledrit, për shkak se mendonin se ishte 'single', por ja që nuk është aspak kështu. Mesa duket, Ledri është në një lidhje prej disa kohësh (të paktën që në 2017-en) dhe e dashura e tij quhet Sara Hoxha. Por përveç fjalëve dhe thashethemeve që qarkullojnë në mediat rozë, indiciet për një lidhje mes tyre mund të gjenden në "Instagrami"-n e Sarës, e cila pas shumë kohësh ka vendosur ta bëjë publik. Në fakt, "investigimi" për një lidhje të mundshme të reperit nisi nga disa postime në "Instagram" ditën e djeshme nga bashkëshortja e Ermal Fejzullahut, Ariana. E pranishme në një festë ditëlindje, së bashku me Ermalin, Ledrin, Kidën dhe disa personazhe të tjerë të njohur, ajo hodhi dhe një foto pikërisht me Sara Hoxha ku duken shumë të afërta. Kjo e fundit ka qenë e pranishme dhe në evente të tjera, së bashku me miq dhe të afërm të reperit. Gjithsesi, nëse shkojmë në profilin e saj dhe shohim pak në detaje fotot mund të zbulojmë disa "të dhëna" interesante. Ka komente që bien së sy të bëra nga Ledri, por edhe nga Ariana Fejzullahu, gjë që tregon se ato janë vërtetë mikeshë, nga Kida, Dhurata Dora e disa artistë të tjerë. Ndoshta duhet përmendur dhe fakti që pothuajse çdo foto e saj, pëlqehet nga mamaja e Ledrit, Xheraldina: Për t'ju prezantuar dhe me faktin final, është kjo foto e 2017-ës, ku Sara këtë postim (që është shumë i bukur), e ka shoqëruar me shkrimin bashkangjitur të shkronjës L. Edhe vendet ku ajo ka udhëtuar, janë të njëjtat me ato ku artisti i këngës "Menemadhe" ka qenë, kështu që po supozojmë se kanë qenë bashkë. Të gjitha detajet na bëjnë të mendojmë një lidhje të mundshme mes të dyve edhe pse asnjëri s'ka konfirmuar asgjë.



**Ledri i dashuruar? Ja vajza që i ka rrëmbyer zemrën dhe detajet që e dëshmojnë këtë**

**K**ëngëtarja e njohur, Vesa Luma, i ka përhëndetur fansat e saj të shumtë me një postim në mëngjes nëpërmjet një postimi në profilin e "Instagram"-it. Vesa publikoi një foto të saj e bashkëngjitur me të shkruan: "Mirëmëngjesi". Fotoja menjëherë mori shumë pëlqime e komente. Por si çdo personazh i njohur, edhe Vesa herë pas here përballet me komente negative dhe kritike. "Qenke bërë e gjitha plastike. Po dil ashtu siç je", i shkruan një ndjekës, të cilës këngëtarja e njohur nuk përton aspak që t'i përgjigjet: "E keni mësuar përmendsh këtë fjalë. Të tregoj një të vërtetë të hidhur për ty ndoshta: Asgjë plastike s'ka këtu". Pas këtij komenti negativ, fansat i kanë ardhur në mbështetje Vesës, të cilët shprehën se ajo nuk ka asnjë operacion dhe që është natyrale. "Sa smirë kanë disa femra e dinë vetëm të flasin budallallëqe. Ku i ka operimet sipas jush?", shkruan një ndjekës e saj. "Shoqja ime super natyrale e bukur", është një tjetër koment. "Është e vetmja pa silikon. Është siç e ka bërë nëna. Je një yll i vërtetë", i del në mbrojtje një tjetër. Ndërsa Vesës nuk i ka munguar as përkrahja e bashkëshortit të saj, Big Basta, i cili i ka bërë një koment me të vërtetë të ëmbël. "Si me plastike si pa plastike, prapë të dua njësoj. S'ke pse e vret mendjen çfarë komentojnë. Ti më ke mua", i shkruan Basta.



**"Krejt plastike", Vesa Luma reagon ndaj fanses: Të tregoj një të vërtetë të hidhur...**

**E**dhe pse sezoni veror ende nuk ka nisur, në "Prestige Resort" kanë nisur të mbërrijnë vizitorët e parë të huaj. Një ndër të është edhe modelja e njohur spanjolle, Natalia Mesa Bush, e cila duket se ka mbetur e mrekulluar nga ambienti në "Prestige Resort". Bukuroshja nga Tenerife ka vizituar së fundi ambientet hotelit prestigjioz buzë detit Adriatik në Golem, ndërsa ka shpërndarë foto për ndjekësit e saj në rrjetet sociale. "Nuk mund të pres", shkruan modelja spanjolle, Natalia Mesa Bush në krah të fotos, ndërsa pozon në ambientet e "Prestige Resort". Mesa duket, asaj i kanë bërë shumë përshtypje ambientet fantastike të resortit dhe ka ndër mend të kthehet sërish aty.



**Modelja seksi spanjolle viziton "Prestige Resort": Mezi po pres**

# BULEVARDI

## POLITIK

Na merrni seriozisht!

### Tre deputetët socialistë që u trishtuan më shumë për Notre Dame de Paris

Djegja e një prej simboleve identifikuese të Francës, katedrales Notre Dame de Paris ka shokuar gjithë opinionin publik mbarëbotëror. Thuajse me të njëjtën ndjenjë është përjetuar kjo ngjarje e rëndë edhe në Shqipëri. Por, ata që e kanë përjetuar më keq janë politikanët tanë, të cilët kanë nxituar të ndajnë në rrjetet sociale dhe kujtimet nga vizitat e tyre në këtë objekt të rëndësishë historike botërore. Tre deputetët socialistë Evis Kushi, Blerina Gjylameti dhe Musa Ulqini kanë kujtuar Notre Dame de Paris nga një udhëtim që kanë bërë në Paris katër vite më parë. Ka qenë deputetja socialiste e Elbasanit, Kushi, ajo që ka publikuar edhe foton e realizuar katër vite më parë. Me sa duket, edhe për disa vite, deputetët socialistë do të duhet të presin sa të rihapet sërish katedralja e njohur që pritet të rindërtohet.



### Zhurma e shashkave dhe thirrjet e protestuesve shqetësojnë ish-deputetët e opozitës

Të shtunën e shkuar opozita e bashkuar protestoi sërish, fillimisht para Kryeministrit dhe më pas para Kuvendit të Shqipërisë, duke kërkuar largimin e qeverisë "Rama" dhe mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Protesta siç është bërë zakon tashmë, është shoqëruar edhe me akte sporadike dhune, hedhje gurësh, shashkash, tymuese dhe boje në faqet e kryeministrit. Por, ndërsa për forcat e rendit problematike mbeten gurët dhe mjetet e tjera të forta që hidhen në drejtim të tyre, për ish-deputetët e opozitës përveç gazit lotsjellës, problem mbeten shashkat dhe në mënyrë të veçantë zhurma që ato shkaktojnë. Siç duket, edhe në këtë foto për ish-deputetin Bardh Spahia, zhurma që shkaktojnë shashkat është bërë aq e padurueshme, sa është detyruar që të mbyllë veshët me duar.



### Lindja e fëmijës së parë, vendimi personal i Meghan Markle...

Meghan Markle është në muajin e nëntë të shtatzënisë dhe së shpejti pritet të sjellë në jetë fëmijën e saj të parë. Pak ditë më parë, një zëdhënës i Kensington Palace ka njoftuar mediat që të mos presin asnjë lajm zyrtar në lidhje me lindjen e fëmijës së princ Harry dhe Meghan. "Duka dhe dukeshja e Sussex-it janë mirënjohës për urimet e mira që kanë marrë nga njerëzit, ndërkohë që po përgatiten për të sjellë në jetë fëmijën e tyre. Shkëlqesia e saj ka marrë një vendim personal për t'i mbajtur private planet në lidhje me ardhjen në jetë të fëmijës. Duka dhe dukeshja do ta ndajnë me të gjithë lajmin emocionues, pasi të kenë festuar së bashku si një familje e re", - thuhet në deklaratën e pallatit mbretëror. "Daily Mail" publikoi pak ditë më parë disa foto ekskluzive të Meghan kur ishte fëmijë. Njëra prej tyre është bërë ditën e parë të jetës së saj, më 4 gusht 1981 së bashku me nënën e saj. Fotot janë shpërndarë për të përditshmen britanike nga daja i saj, Joseph Johnson.



### Mihail Gorbaçov, kandidati më i ri në parlamentin indonezian

Mihail Gorbaçov quhet kandidati për zgjedhjet parlamentare në Indonezi që do të zhvillohen javën e ardhshme, por në rastin konkret nuk bëhet fjalë për ish-liderin sovjetik, që i dha fund Luftës së Ftohtë. Mihail Gorbaçov Dom, emri i tij i plotë, është një i ri indonezian 32-vjeçar, i cili aspiron të fitojë postin e deputetit në këtë shtet të Azisë Juglindore. Një njohës i mirë në fushën e mjedisit, ai u lind në 1986 në periudhën kur Gorbaçovi udhëhoqi Perestrojkën, një lëvizje reformiste me ambicën për të modernizuar ish-BRSS-në, megjithëse nuk mundi të pengojë shpërbërjen e bllokut sovjetik.



## Këshilla

**E**kspertja e dietave, Juliette Kellow, ka 20 mënyra të reja se si të humbni peshë dhe të sillni trupin në formë për pushimet verore në plazh. Dëshironi të keni forma të përkryera, por pa mbajtur ndonjë dietë? Këtë tani mund të bëni nëse ndiqni 20 këshillat e doktorëshes Kellow, e cila ka hulumtuar për mënyrat e lehta nëse nuk dëshironi të trupin ideal.

### 1. Mbushni një pjatë të madhe me drithëra...

Shumicën e kohës tuhet se duhet të hamë më pak, por sipas një studimi të "Penn State University", nëse hamë vetëm drithëra për mëngjes, atëherë duhet të jenë në sasi më të madhe. Studimi tregon se nëse sasia e drithërave është më e madhe, ndihmon në humbjen e kalorive më shumë se një sasi e vogël. Në këtë mënyrë, trupi juaj do të fillojë të humbë kalori, duke u formësuar në mënyrë më të mirë.

### 2. Nuk duhet të ndiqni televizionin ndërsa jeni duke ngrënë

Keni mundësi më të mirë që të keni trup më të mirë, nëse ndizni radion. Një studim i bërë me 6.500 të rritur ka treguar se ndërkohë që ushqehen shikojnë edhe televizionin, nuk i kushtojnë rëndësi ushqimit, duke shtuar kështu shanset për mbipeshë. Mbani shënime se çka po hani. Për shembull, nëse reduktoni një copë bukë, pak gjalpë dhe mjalte ju mund të humbni 140 kalori në ditë.

### 3. Bëni përzgjedhje më të mirë të ushqimit

Sipas Universitetit të Cornell, ne zgjedhim ushqimin e parë që e shohim në meny të restorantit, apo në frigorifer. Në një anketë të bërë, 86% kanë zgjedhur frutat kur u janë ofruar së pari, kurse 55% kanë zgjedhur kur i është ofruar në fund. Përzgjedhni ushqimet më të shëndetshme. Nëse zgjidhni një pjatë me më pak yndyrë, mund të evitoni shumë lehtë 300 kalori në ditë.

### 4... dhe vendosini në tabaka

Sipas të njëjtit universitet, ushqimin duhet të vendosni në tabaka, pasi ata që e mbajnë vetëm pjatën, kanë mundësi të marrin me vete vetëm ëmbëlsirën dhe jo sallatën. Në



# 20 mënyra të reja se si të humbni peshë dhe të keni trupin tamam për plazh

tabaka ka vend më shumë dhe mund të merrni gjërat e shëndetshme, edhe nëse nuk do t'i konsumoni. Nëse e ndërtoni ëmbëlsirën që ka 400 kalori me sallatën që përmban 30 kalori, dalimi në trupin e juaj do të jetë ndryshe brenda muajit.

### 5. Merrni probiotik në baza ditore

Femrat që janë dobësuar duke përdorur probiotik, kanë humbur pesë kilogramë në 12 javë, dy kilogramë më shumë se ato që nuk kanë përdorur. Ky është zbulimi që ka bërë Universiteti i Qubeck në Kanadë. Zgjidhni probiotikun e duhur, që bën balancimin e bakteve në zorrë, në krahasim me atë që pretendon se është shumë më i shëndetshëm.

### 6. Hani ushqime më të forta

Një hulumtim i Universitetit të Floridës ka zbuluar se të rriturit janë më shumë të prirë të hanë ushqime të buta, në krahasim me ato të forta. Mirëpo nëse hamë ushqime të forta, trupi ynë gjatë përtypjes shpenzon rreth 50 kalori, që në baza javore është mbi gjysmë kilogrami. Përfitimi në trupin për plazh: Meqenëse pjesa e belit gjithmonë vihet në pah kur jemi në plazh, zëvendësoni ushqimet e buta, me ato që janë më të forta. Për shembull zgjidhni mishin copë, ndërsa largoni mishin e grirë, njësoj veproni kur zgjidhni mes bananes

apo mollës.

### 7. Qëndroni në humor të mirë

Hulumtuesit në Institutin e "Delaware" kanë arritur në përfundim se personat në humor të mirë kanë më shumë mundësi që të zgjedhin ushqim të shëndetshëm. Nëse hiqni dorë çdo ditë nga një ëmbëlsirë, i keni kursyer vetes nga 250 kalori në ditë, që i bie afro gjysmë kilogrami në muaj.

### 8. Bëhuni të vëmendshëm me ushqimet e shëndetshme

Një studim i ri tregon se pothuajse të gjithë të rriturit, sapo e shohin mbishkrimin "e shëndetshme", nuk e lexojnë përmbajtjen e ushqimit. Kjo nuk do të thotë se gjithmonë këto ushqime janë të shëndetshme. Gjithmonë shikoni përshkrimin e kalorive, pasi përmbajtja mund të ju mashtrtojë. Më pak yndyrë, për shembull do të thotë më shumë sheqer.

### 9. Përdorni parfum

Kur nuhasim e erën e mishit, bukës, supës apo çokolletës na shtohet apetiti, në krahasim me aromat tjera siç është ajo e pishës, apo e barit të prerë, që e bën të kundërtën. Kur nuhasni ushqimin, ndizni qirinj aromatik, vendosni parfum në trup dhe në dhomë, apo përdorni mjete higjienike, në mënyrë që të shpërqendroheni nga ushqimi.

### 10. Lëreni gotën në tavolinë kur e mbushni me

verë

Në Universitetin e Ajovës kanë arritur në përfundim se nëse e zbrazim verën në gotën që e mbajmë në dorë, e mbushim 12% më shumë, se sa në gotën që është në tavolinë. E njëjta gjë ndodh edhe me formën e gotës. Vendosni gotën në tavolinë kur e zbrazni verën, pasi me 12% më pak ju keni evituar 20 kalori për një gotë, që në baza mujore është një gjysmë kilogrami.

### 11. Mendoni sikur çdo ditë të jetë e hënë

Në fillim të javës gjithmonë jemi më të vëmendshëm dhe kujdesemi që të respektojmë dietën. Kjo ndodh në 80% të rasteve. Mbani shënime se sa e respektoni mënyrën e të ushqyerit në ditën e parë të javës dhe krahasoni me ditët tjera. Ju mund të evitoni mbi 500 kalori, që është afro dy kilogramë në muaj.

### 12. Kujdesuni që të hani perime bishtajore

Studimi i Universitetit të Luizianës tregon se personat që hanë perime bishtajore janë më elegantë se ata që nuk hanë. Mundësi që të vuajnë nga mbipeshë kanë 53% më shumë, personat që nuk përdorin perime bishtajore. Përfitimi në trupin për plazh: Vendosni perime bishtajore në sallatë, sepse kanë më pak kalori se misri, djathi apo gjëra të ndryshme të pjekura. Nëse veproni kështu, për 30 ditë, mund të evitoni gjysmë kilogram.

### 13. Reduktoni kripën

Ushqimet që i marrim me vete nga restoranti, si picat apo produktet e pastigerisë janë të mbushura me kripë dhe me shumë kalori. Për këtë duhet të kemi kujdes sepse ushqimet me kripë shkaktojnë shtim peshe. Hiqni dorë menjëherë nga ushqimet me shumë kripë.

### 14. Fokusohuni në drekën që hani

Universiteti i Birminghamit ka arritur në përfundim se femrat që nuk hanë drekën si duhet, në 30% të rasteve hanë gjëra të tjera më vonë. E kjo do të thotë 30% më shumë kalori. Ndaleni telefonin, televizionin dhe kompjuterin, e fokusohuni 100% në gjellën që hani. Reduktoni më pas 100% gjërat tjera që hani, në mënyrë që të mos shtoni një kilogram më tepër në muaj.

### 15. Merrni rreze dielli në mëngjes

Njerëzit që u ekspozohen rrezeve të diellit në mëngjes kanë më shumë përparësi se ata që shfrytëzojnë këtë ngrohësi pasdite, sepse drita e rregullon qarkullimin e gjakut, gjë që ndikon direkt në metabolizëm. Bëni xhiro me biçikletë dhe digjni nga 250 kalori për 30 minuta. Kjo ju ndihmon të hiqni nga një kilogram në muaj.

### 16. Vini erëza në ushqim

Studiuesit në Universitetin e Kolorados kanë vërtetuar se nëse shtoni erëza si rigon, por hudhra, qepa apo speca djegës mund të zëv-

endësoni ushqimet me yndyrë me ushqime të shëndetshme dhe të keni të njëjtën shije. Kështu ju mund të hani një pjatë që ka 295 kalori, në krahasim me një që ka 610 kalori.

### 17. Mos hani si të tjerët, nëse nuk është e shëndetshme

Universiteti i Liverpulit ka arritur në përfundim se ne jemi të prirë të zgjedhim ushqimin e njëjtë si shoqëruesit tanë. Fat i mirë nëse kemi dikë që ushqehet shëndetshëm, por nuk ndodh e njëjta me ata që zgjedhin ushqime me shumë kalori. Porositni i pari nëse jeni në një grup, duke u bazuar në ushqimin e shëndetshëm që të tjerët të ndjekin shembullin tënd.

### 18. Bëhuni mbretëreshë e kalorive kur hani jashtë

Shumë dyqane të ushqimit të shpejtë tashmë kanë edhe përshkrimin se sa kalori përmban pjata, prandaj nëse kujdeseni mirë, mund të kurseni 215 kalori duke porositur ushqime më të lehta.

### 20. Largoni joshjen nga pija

Universiteti i Birminghamit ka ardhur në përfundim se njerëzit që mbajnë dietë, nuk mund të rezistojnë joshjes nga pija gjatë mbremjes. Kjo është një lajm i keq për vijën e trupit, sepse një gotë verë, ka 250 kalori. Përfitimi në trupin për plazh: Zëvendësoni një gotë verë, me xhin dhe tonik që ka 50 kalori, që do ndihmojë të evitoni një kilogram në muaj.

## EKSPOZITA

Muzikant dhe bir i një familjeje të persekutuar, Lekë Tasi e pati nisur rrugën e pikturës si nxënës i Nexhmedin Zajmit



# LEKË TASI

## Artisti që njohu persekutimin, shfaqen vizatimet e një jete


Fatmira Nikolli

*Ekspozita e 90-vjeçarit, duke mos mundur të shprehej lirishit përdori lapsin*

Më 1975 jam internuar për arsye politike në Grabjan të Lushnjës, dmth., i përkisim një familje të persekutuar. Babai, xhaxhai, daja, vëllai, kishin qenë në burg. Ishte një valë egërsie që unë bashkë me shumë të tjerë u internova. Me ndryshimin që më ndodhi në vitin 1967 violonçelin e lashë. Kjo ishte një traumë për mua, por mua më dha mundësi që unë të bëhesha piktor. Burgun babai, xhaxhai, daja, vëllai e kishin bërë për bindjet e tyre, sepse ishin antikomunistë. Pas internimit, viti 1990, jam kthyer në Tiranë ditën që Kristofor Kolombi zbuloi Amerikën, 12 tetor 1990. Në internim, 2 vitet e para kam jetuar me artin në mbremje, më mbeti zakoni për të punuar më pas u lodha".

Lekë Tasi e kujtonte me pak fjalë jetën e tij të vështirë. Më 1957 u hoqën nga ekspozita dy punime të tij, ndërsa më 1967 pushohet nga puna për arsye politike dhe si i persekutuar punoi në fermë deri më 1971 ai është përkthyes në Institutin e Tokave në Tiranë, deri më 1975 e gjejmë punëtor bujqësie në Stacionin e farërave dhe për 15 vitet e ardhshme të internuar politik në fshatin Grabjan të Lushnjës.

Teksa shënon 90-vjetorin e lindjes, në Galerinë FAB, 'Harabel Contemporary Art Platform' dhe Universiteti i Arteve i çelin këtë të mërkurë ekspozitën vetjake me titull "Vizatime të një jete". Ekspozita është kuruar nga studiuesi Zef Paci dhe Platforma Harabel dhe qëndron e hapur për publikun në



FAB përgjatë datave 17 - 28 prill 2019. Platforma 'Harabel' mundëson për herë të parë ekspozimin e vizatimeve të Lekë Tasis dhe kjo organizohet me rastin e 90-vjetorit të autorit. Për këtë arsye, u mendua kjo paralele ndërmjet ardhjes, lindjes dhe vizatimit si lindje, zanafillë, si ngjizje e veprës së artit. Ekspozita është një përzgjedhje në

kërkimin artistik tejet afatgjatë të një personi që dikur jetonte në persekutim, i cili, duke mos mundur të shprehej lirishit nëpërmjet të flurrit dhe shkrimit, ka përdorur dhe përdor vizatimin si një mjet komunikues në jetën e përditshme. Vizatimet e tij ruajnë frymën e historive të vogla, anekdotave, lojës, thashethemeve; herë-herë përcojnë

dicka epshore. Ai kërkon të tërheqë e drejtojë vëmendjen nëpërmjet asaj çka vizaton kah tenseioneve të fshehura dhe të padëguara që gjallojnë hapësirën. Lekë Tasi ka lindur në vitin 1929 në Athinë në një familje emigrantësh shqiptarë. Ai studioi muzikë dhe punoi si violonçelist në Radio, Filarmoni dhe në Teatrin e Operës (1946-1967). I pushuar për arsye politike, u internua në Myzeqe, ku u mor me punë bujqësore. Lirimi i plotë erdhi në vitin 1990. Në vitin 1991 u emërua në sekretariat për fenë në Ministrinë e Kulturës dhe më vonë në Kryeministri, ku qëndroi deri në vitin 1998. Ai është marrë qysh i vogël me pikturë; fillimisht me grafikë (akuarel, tempera, pastel, bojë kineze, flomaster) dhe më vonë gati tërësisht me vaj. Megjithatë autodidakt, punimet e tij janë çmuar qysh herët nga piktorët e mirënjohur: Mio, Buza, Zajmi dhe Paskali, me të cilët këshillohej. Lekë Tasi ka marrë pjesë në ekspozitën e përbashkët të organizuar nga Fondacioni Soros (1992) te Piramida dhe katër herë në GKA (në vitet 1992, 2003, 2007, 2015). Së bashku me piktorët Ll. Blido dhe R. Guçi kanë ekspozuar në galerinë "Jozef" (Durrës, 2005). Ka qenë pjesëmarrës në ekspozitën "Onufri" tri herë përgjatë viteve '90; pjesëmarrja e fundit shënohet në vitin 2004 me ekspozitën me titull "Vende të spikatura".

Ndër ekspozitat vetjake përmenden ato në galeritë: "Exit" (Pejë, 2005), "Zeta" (Tiranë, 2012), si dhe "DIDART" (Tiranë, 2008-2012). Përtej Shqipërisë, ka ekspozuar në Muzeun e Artit Bashkëko-

hor në Xhenova (Genova, Itali) bashkë me 25 artistë të tjerë në ekspozitën "Arti në Shqipëri - para dhe pas vitit 1990" (nëntor 2009 - shkurt 2010). Në mënyrë vetjake, në Alba, Galeria d'Arte - Angelo Galeasso, ka hapur ekspozitën "La Mia Accademia delle Ore Libere" (21-29 korrik 2014). Në prill të vitit 2016 ka marrë pjesë së bashku me 163 artistë shqiptarë në veprimtarinë e Luciano Benetton Collection "Imago Mundi". Lekë Tasi shquhet si një zë i ndryshëm e modern në botën e pikturës tradicionale shqiptare dhe për këtë ai duhet të zërr vendin që i takon në historinë e artit shqiptar. Deri në vitin 1975 piktori ekspozoi vetëm disa punë, edhe pse kishte një krijimtari shumë të pasur. Pas viteve 1990, tashmë si profesionist ai iu drejtua jo vetëm ekspresionizmit, por disa zhvillimeve të artit modern të shekullit XX. Ai pa me vëmendje, me seriozitet dhe intësi prurjet surreale, naiviste dhe të abstraguara. Piktori dhe mik i tij Llambi Blido shkruan: "Muzikant dhe bir i një familjeje të persekutuar, Lekë Tasi e pati nisur rrugën e pikturës si nxënës i Nexhmedin Zajmit. Realizmi i thjeshtë i akuareleve të tij të viteve '50 ushqejë nga dashuria e përjetshme e këtij përmetari për Tiranën ku u rrit. Në çdo tablo të këtij autori, në etapën aktuale të pjekurisë së plotë, siç erdhi në ekspozitën e vitit 2015 në GKA, çdo befasi, është në fakt befasi e fabulës. Atë ai e zhvillon me imagjinatën e tij dhe e realizon në lirshmëri falë aftësive kreative-improvizuese të admirueshme në çdo kënd të tablosë".

## FRANCE DRAMA

**B**rigada e zjarrfikësve të Parisit tha të martën se struktura e katedrales së famshme të Notre Dame është shpëtuar, së bashku me punimet kryesore të artit, pasi 400 zjarrfikës luftuan për më shumë se nëntë orë me një zjarr që shkaktoi dëme masive. Dy kullat ikonë të ndërtësës dhe struktura e gurit i rezistuan zjarrit, por çatia dhe maja e katedrales së shekullit të 12-të, u shembën nga flaka. Kryebashkiakja e Parisit, Anne Hidalgo, falënderoi zjarrfikësit dhe oficerët e policisë që ndihmuan në shpëtimin e objekteve të shenjta dhe veprave të mëdha të artit nga katedralja. Ajo tha se Notre Dame është një vend ku "rezonohet shpirti i Parisit". Brigada e zjarrfikësve tha se dy policë dhe një zjarrfikës u plagosën gjatë përpjekjes për të shuar zjarrin. "E keqja më e madhe u shmang, edhe pse beteja nuk është fituar ende plotësisht", tha presidenti francez, Emmanuel Macron, para gazetarëve në katedralen pak para orës lokale të mesnatës. Ai tha se do të niste një fushatë kombëtare për grumbullimin e fondeve për të rindërtuar katedralen dhe u bëri thirrje "talenteve më të mëdhenj" të botës për të ndihmuar me këtë përpjekje.

### DHURUESIT

Disa orë më vonë, miliarderi francez François-Henri Pinault premtoi 113 milionë dollarë ndihma në përpjekjen e rindërtimit, i ndjekur shpejt nga një tjetër miliarder francez, Bernard Arnault, familja dhe kompania e të cilit tha se do të kontribuonin me 226 milionë dollarë. Nuk është e qartë se çfarë e shkaktoi zjarrin, megjithëse mediat franceze njoftuan zyrtarët të kenë thënë se ai mund të ishte "i lidhur potencialisht" me punët rinovuese që po bëhen në ndërtesë. Disa pjesë të ndërtesës ishin nën skela dhe zyrtarët thanë se statujat prej bronzi u hoqën menjëherë dhe kaluar për rinovimin. Zyra e prokurorisë së Parisit tha se ka nisur një hetim mbi zjarrin dhe tha se po e trajtonte incidentin si një zjarr "të pavullnetshëm".

### VATIKANI

Vatikani lëshoi një deklaratë ku shprehet tronditje dhe trishtim dhe e quajti Notre Dame një "simbol të krishterimit në Francë dhe në botë". Zjarrin ndodhi gjatë përkujtimeve të Javës së Shenjtë dhe më pak se një javë para Pashkëve. Një mesazh për Pashkët ishte planifikuar për në katedrale të dielën. Kryepeshkopi i Parisit, Michel Aupetit, ftoi

### 14 MILIONË

Notre Dame vizitohej nga 14 milionë turistë çdo vit. Katedralja u përfshi nga flakët mbrëmjen e djeshme. Ajo u ndërtua në vitin 1267 si tempulli i parë i krishterë në Paris. Emri i saj do të thotë "Zonja jonë" dhe i dedikohet virgjëreshës Mari.



Miliarderi François-Henri Pinault premtoi 113 milionë dollarë për rindërtimin. Fillojnë donacionet

# Notre Dame, shpëtojnë nga djegia kullat ikonë

Anne Hidalgo: Kisha është një vend ku "rezonohet shpirti i Parisit"



## Parashikimi i Nostredamus, për kishën që do digjej...

**N**jë ngjarje aksidentale, por që "preku" një nga objektet më të shenjta për Europën, katedralen Notre Dame, ka shokuar europianët. Katedralja u dogi të hënën, ndërsa muret e saj kanë shpëtuar. Por ajo që shton akoma më tepër habinë për ngjarjen është se atë e ka parashikuar edhe Nostredamus, një nga parashikuesit më të famshëm të historisë. "...Zonja jonë do të qajë për të gjithë ne dhe do të shkëlqejë në distancë... Me ardhjen e pranverës, një kishë e të gjitha kohërave do të digjet për mëkatarët...", thuhet të ketë parashikuar Nostredamus. Me këto fjalë, Nostredamus ka arritur të parashikojë djegien e kishës. Sipas tij, djegia ndodh për shkak të mëkateve të mëdha të njerëzve. Nostredamus, astrolog dhe mjek i shekullit të 16-të, përpiloi një libër me parashikimet më të famshme me titullin "Profecitë". Ai parashikoi zjarrin e madh të Londrës më 1666, vdekjen e Henrik të Dytë, si dhe ngritjen në pushtet të Hitlerit në Gjermani.



## Zjarrin në kishën Notre Dame, 50 persona nën hetim nga prokuroria

**P**rokurorët francezë kanë deklaruar se zjarrin që ka rënë në ndërtesën e Notre Dame ka gjasë të jetë aksidental. Kombi francez, Europa dhe bota u trondit nga ngjarja e paprecedentë e djegies së katedrales, simbol kulturor në Paris. Më shumë se 400 zjarrfikës kanë marrë pjesë në shuarjen e flakëve në katedrale. Ata punuan 14 orë rresht për të shuar flakët në katedralen 8-shekullore. Prokurori publik Paris, Remy Heitz, tha se nuk ka asnjë shenjë të



dukshme se kemi të bëjmë me zjarrvënie, shkruan "Reuters". Pesëdhjetë persona janë duke hetuar për atë që e kanë konsideruar si rast kompleks hetimi. Ndërtesa u

mbyll mbrëmë për publikun vizitues. Lajmi i mirë është se muret kryesore arritën që të qëndrojnë në këmbë, duke mos djegur totalisht ndërtesën me vlera të veçanta kulturore e historike për Francën. Prokurori i Parisit ka hapur një hetim për "shkatërrimin e pavullnetshëm nga zjarrin". Prokuroria po merr në pyetje punëtorët që morën pjesë në restaurim. Shumë njerëz mbrëmë janë lutur për objektin e rëndësishëm të veçantë.

priftërinjtë anembanë Francës t'u binin kambanave të kishave në një thir-

rje për lutje. Zjarrfikësit në Paris evakuuan ndërtesat pranë Notre Damit dhe pas-

truan zonën rreth katedrales, ndërsa hiri ra mbi blloqet përreth. Mijëra

dashamirës u rreshtuan në urat mbi lumin Senë vonë në mbrëmjen për të parë skenën, ndërsa të tjerë u mbledhën pranë kishës Saint Julien Les Pauvres duke kënduar himne dhe duke bërë lutje. Katedralja katolike mes-

jetare është një nga monumentet historike më të vizituara në Evropë, që pret çdo vit miliona njerëz. Ajo është e famshme në portretizimin e romanit klasik të Viktor Huges, "Kurrijoja i Notre-Dame". /Voa

Opinion i Ditës

# Ne e dogjëm vetë katedralen tonë

Nga Armand Shkullaku

(vijon nga faqja 1)

...godine mund të prekë aq thellë në brendësinë e qenieve njerëzore. Të shtangur, me një vështrim të mpirë prej trishtimit, me dhimbjen për atë masë gurësh mbi 800-vjeçarë, njerëzimi përjetoj rrënimin e një pjese të historisë së tij. Dukej se në flakë nuk po kallej një ndërtesë, por një qenie e gjallë, që kish marrë jetë në shekuj në shpirtin e çdo francezi. Ndoshta e njëjta dhembje, mbase edhe më e madhe, nëse do të bëhej fjalë për një tragjedi me jetë njerëzore.

Ekzistenca e një ndërtese mund të marrë trajtën e një ekzistenca njerëzore përsa kohë ajo është e lidhur me kujtimet e atyre që jetojnë me të. Ajo kthehet në pjesë të jetës së tyre jo thjesht si objekt, por si një dëshmitare e dashurive, vuajtjeve, gëzimeve, ngjarjeve të vogla apo ndodhjeve të përditshme. Bëhet pjesë e rrëfimeve dhe e memorie njerëzore, mbartëse e kujtimeve qindrvjeçare që brezat ua transmetojnë njëri-tjetrit. Ekzistenca e saj është diçka që njerëzit e zakonshëm e përcjellin edhe si dëshmi të ekzistencës së tyre. Duke e pasur të pranishme në rrëfimet e tyre, ata komunikojnë me të, krijojnë një raport të veçantë emocional, preken kur rikthehen pas një mungese të gjatë, u mungon kur



largohen nga vendi i tyre, mjafton një foto që t'i përlotë, duke përzierë në shpirtin kujtime të largëta që ai objekt i mbart ndër gurët e tij.

Janë pikërisht këto ndërtesa, qofshin madhështore si Notre Dame apo të thjeshta si kinemaja e vjetër e një lagjeje, që lidhin rrënjët dhe shpirtin e atyre që jetojnë bashkë me to. Ato përbëjnë "memorien e pafajshme", që i bën njerëzit më të ndjeshëm, më të butë, më të dashur me njëri-tjetrin, që krijojnë historinë e vogël të përbashkët dhe kujdesin për ta përcjellë

atë të padëmtuar tek ata që vijnë më pas. Kjo memorie mban gjallë emocionet, nostalgjinë, historinë dhe vetë rrëfimin e lashtë që i jep kuptimin jetës njerëzore. Godinat, pemët, rrugicat, madje edhe qentë apo macet e lagjes, që e përbëjnë këtë memorie, frymojnë bashkë me banorët e tyre. Ndaj, humbja e tyre dhemb po ashtu si një humbje njerëzore.

Shoqëritë njerëzore që nuk e kanë këtë dimension të ekzistencës së tyre, janë më të vrazhda, me mungesë thuajse të plotë të solidaritetit human. Ato motivohen

nga materializmi, eksitimi për të fituar, individualizmi dhe papërgjegjshmëria ndaj të përbashkëtës. Për këto shoqëri, gjithçka fillon e mbaron brenda mureve të shtëpisë së tyre. Memoria e tyre regjistron vetëm vlerën e pasurisë që mund të mbledhin, si të vetmen vlerë që do të lenë pas. Rrëfimi i përbashkët që do t'i bënte qenie më sociale, më të ndjeshme e më të përgjegjshme, e ka humbur fillin dhe konfliktin, si dominim i më të fortit, kthehet në ligjësi.

Ne të gjithë jemi dëshmitarë se si ndër dhjetëra vjet ranë të gjitha godinat, lagjet dhe hapësirat ku gjallonin kujtimet tona. Bashkë me to u fshi edhe ajo memorie e pafajësisë që kishte rritur disa breza. U zhduk Tirana historike, shpëtitë e vjetra, pastaj me radhë kinematë, fushat e sportit, dyqanet e vogla, parqet e lodrave. U shkatërrua lulishtja emblemmatike e sheshit "Skënderbej", u shemb stadiumi, do të prishet Teatri Kombëtar, Durrësi antik e kështu me radhë. Më të fortët do ngrënë kulla, ndërtesa moderne, kryevepra të arkitekturës, të cilat do të prodhojnë memorien tonë të re, atë të asgjësimit të përkatesisë së përbashkët dhe lartësimit të etjes për të fituar, duke shkelur mbi gjithçka e mbi gjithkënd.

Praj shumë vitesh po ecim në këtë rrugë dhe habitemi pse jemi gjithnjë një shoqëri në konflikt

permanent. Prekemi papritur vetëm nga një foto bardhezi, që dikush e hedh në "Facebook" e na provokon nostalgjinë për qytetet tona, e mbaron brenda mureve të shtëpisë së tyre. Memoria e tyre regjistron vetëm vlerën e pasurisë që mund të mbledhin, si të vetmen vlerë që do të lenë pas. Rrëfimi i përbashkët që do t'i bënte qenie më sociale, më të ndjeshme e më të përgjegjshme, e ka humbur fillin dhe konfliktin, si dominim i më të fortit, kthehet në ligjësi.

Ne të gjithë jemi dëshmitarë se si ndër dhjetëra vjet ranë të gjitha godinat, lagjet dhe hapësirat ku gjallonin kujtimet tona. Bashkë me to u fshi edhe ajo memorie e pafajësisë që kishte rritur disa breza. U zhduk Tirana historike, shpëtitë e vjetra, pastaj me radhë kinematë, fushat e sportit, dyqanet e vogla, parqet e lodrave. U shkatërrua lulishtja emblemmatike e sheshit "Skënderbej", u shemb stadiumi, do të prishet Teatri Kombëtar, Durrësi antik e kështu me radhë. Më të fortët do ngrënë kulla, ndërtesa moderne, kryevepra të arkitekturës, të cilat do të prodhojnë memorien tonë të re, atë të asgjësimit të përkatesisë së përbashkët dhe lartësimit të etjes për të fituar, duke shkelur mbi gjithçka e mbi gjithkënd.

Praj shumë vitesh po ecim në këtë rrugë dhe habitemi pse jemi gjithnjë një shoqëri në konflikt

Lapsi.al

Opinion i Ditës

Nga Dr. Hajri Mandri

# Gjeneral Rrahman Parllaku dhe mesazhet e shekullit të Tij

Më 17 prill 2019, Heroi i Popullit, Gjeneral Rrahman Parllaku, mbush një shekull jetë duke u bërë model i mbijetesës, qëndrimeve dhe vlerave. Me memorie të freskët, dhe shëndet të mirë, bart në kujtesë imazhe groteske të skenave më të skajshme të intelektualit me veprimtari të dendur në drejtim, veprim dhe qëndrim dhe na vjen në jubileum e 100-vjetorit të tij, si dëshmitar okular i historisë së Shqipërisë dhe shqiptarëve, sublimitetit dhe vlerave, arritjeve dhe gabimeve historike, luftës dhe qëndrësës, ëndrrave dhe shpresave që rriteshin e veniteshin, nën një mbijetesë sakrale.

I lindur në Veri të Shqipërisë dhe rritur e formuar në Jug dhe në Shqipërinë e Mesme, Gjeneral Parllaku e njohu Atdheun gjeografik me pëllëmbë, duke qenë prezent në të gjitha ngjarjet dhe sfidat e kohës, si pjesëmarrës aktiv në bëmata e mëdha në luftën për liri, dinjitet shoqëror dhe demokraci. Ai lëviz në historinë e shekullit të tij, hijerëndë me virtyte të larta, me përkushtim kombëtar, qytetar e shoqëror me ndikim të fuqishëm publik. Jetën dhe veprën e tij nuk e nxënë kufijtë e Shqipërisë shtetërore, por atë do

ta gjejmë në luftëra dhe përpjekje dhe në viset e tjera shqiptare, në mbrojtje të lirisë, pavarësisë dhe të drejtave të shqiptarëve. Në spiralet e historisë, Gjeneral Parllaku ka ditur të lakohet me dinjitet duke patur si kolonë bazë përkushtimin kombëtar shqiptar dhe progresin shoqëror, si thelb i motivimit që gëllonte shpirtin e tij progresist e lirisdashës. Vështrim të përbledhësh në pak radhë, në kuuesencë, motivimin e personalitetit të tij, zhvillimin konjitiv e psikomotor të këtij djaloshi që ngjitet nga Novosej i Kukësit në tribuna të larta shtetërore, në hero të popullit të tij, në drejtues madhor ushtarak, duke ndryshuar variablat në kontekste politike në funksion të mbijetesës dhe qëndrësës, nga udhëheqës i shquar në të dënuar me burg, nga triumfator në grigjë të rrezikut për jetën, nga piedestali i kuadrit të dobishëm në stigmën e "njeriut të rrezikshëm", ekstreme këto që provokuan në personalitetin e Tij, qëndrime dhe vlera të larta politi-

ko-shoqërore në raportin e ndjenjave të forta estetike midis dashurisë dhe urrejtjes. Këtë vullm ideor dhe estetik e përcjellë përgjatë shekullit të jetës së tij, një burrë shtetar, një organizëm vital, një mendje koherente dhe një vizion largpamës dhe perspektiv. Retrospektiva dhe perspektiva kanë një prerje të artë në personalitetin e Gjeneral Parllaku, atë e përshkon frymëzimi dhe dashuria për Atdheun e tij, si leitmotiv vijues mbikohor që çliron në rrethana tipike energji shpirtërore pozitive në luftën e jetës. Jeta e Tij e përshkruar në këtë libër është një shembëlltë e rrallë që na fton të kuptojmë se jeta meriton të jetohej kur luftohet forta dhe fitohet. Si një ushtarak, korrekt, i shquar ai mbështetëj në skrupuj të fortë të moralit kombëtar, me pikëvështrim të qartë dhe të kthjellët, duke ngjitur një nga një shkallët e karrierës ushtarake, si një gjigand hijerëndë që ngjitet i sigurt në bedenat e kalasë. Kalaja e pushteteve në kohë të ndryshme dhe situatë të

ndryshme pati dhe shembje morale e politike, por këto nuk e dobësuan dhe përlulën Gjeneral Rrahman Parllakun, këtë soj të fortë shqiptari që me mençuri diti të manovrojë në spiralet e rrezikshme të historisë shqiptare.

Heroi i luftës në terren, i luftës dhe përballjes në gjyq ushtarake, përballoi burje e privime dhe fitoi duke merituar lavdinë dhe pavdekësinë. Jeta iu afrua heroit herë me tufë me lule, herë duke u derdhur mbi të, me tërë egërsinë e saj. Rrallë gjen shembuj të tillë të personalitetit ku të jenë ngjizur e plazmuar në mënyrë aq mjesh-tërore vetitë e karakterit të një intelektual patriot, të aftë drejtuesi e komanduesi të aftë ushtarak, të zgjaur dhe trim, të thjeshtë dhe të ndershëm, të bukur në trup, shpirt dhe mendime. Ai është një shembëlltë e ardhur nga genocidi komunist, si dëshmitar i gjallë për të kuptuar dhe vërtetuar peripecitë dhe traumat që kaloi ky popull i orientuar dhe i ideologjizuar gabimisht nga rryma dhe

korrente të huaja.

Mbi 20 vjet në krye të Shoqatës së Veteranëve të Luftës, me ndershmëri dhe principe të larta morale ka kontribuar në ndriçimin e mjaft skenave dhe protagonistëve, të vërtetave dhe kërkimeve historike duke dhënë edhe në moshë pensioni, një ndihmesë të vyer në emancipimin politik-shoqëror e demokratik të shoqërisë. Si një lundërtar i shquar ai e drejtoi varkën e shpëtimtut duke kapërcyer me sukses tallazet e historisë deri në brigjet e paqta të demokracisë që po jetojmë. Jo vetëm gjatësia kohore e jetës por dendësia dhe përm-bushja e saj me veprime, qëndrime dhe vlera në përmbytjen e saj, e bën këtë figurë të lartësohet në nderimin tonë shoqëror, ku zëri dhe mesazhet e Tij dëgjohej deri në organizata famoze ndërkombëtare. Në këtë vështrim Gjeneral Rrahman Parllaku përmbledh një shembull frymëzimi për atdeshdashurinë dhe përkushtimin qytetar.

Pedagog, Albanian University.

Opinion i Ditës

# Eliminimi i të korrumpuarve, interes rajonal i Perëndimit

Nga Spartak Ngjela

(vijon nga faja 1)

... drejtuan racionalizmit, por vetëm gënjeshtërs dhe kërcënimit me destabilizim të Shqipërisë. Po vallë, a e kuptojnë dot këta gjykimin racional! Jo, nuk e kuptojnë dot. Prandaj, që të katërt, gjithmonë kanë sunduar me anë të manipulimit të zgjedhjeve dhe me korrupsion. Sepse kanë dashur të sundojnë dhe jo të menaxhojnë shtetin shqiptar. Asnjëherë këta nuk luajtën për interesin kombëtar. Kurse tani janë në prag të falimentimit.

Është kjo arsyeja që, që të katërt janë duke ecur drejt likuidimit të tyre. Po si?

I. Politika amerikane dhe ajo gjermane tani kanë gjithçka në dorë në Shqipëri. Dhe ky ishte shpëtimi i Shqipërisë dhe shqiptarëve pas dyqind vjetësh luftë për të shpëtuar ekzistencën e tyre të kërcënuar me shfarosje etnike.

Amerikanët, në vitin 2016 formuluan Kushtetutën shqiptare antikorrupsion dhe antitirani në Shqipëri. Kushtetuta përban në vetvete procedurën e likuidimit të korrupsionit të lartë shtetëror.

Berisha që e ndjeu menjëherë rrezikun e likuidimit të tij penalisht, me shumë pasion kërkoi të krijonte një krizë tërësore në Shqipëri, edhe pse me forcë u detyrua të votonte Kushtetutën. Ai ka tani tre vjet që po i luan të gjithë gurët e destabilizimit të Shqipërisë, dhe ka dështuar.

Por, çfarë po ndodh me Ramën?

Rama, në dy vjet rresht, ndjen thuasje pasiv, ndërsa tani ndihet i mpirë politikisht në funksion të reformës, të cilën ai kuptohet që nuk e do.

Kurse politika amerikane vepron ndryshe. Në funksion të Reformës në Drejtësi, asaj i erdhin përshant dëgjia e mandateve të deputetëve të Partisë Demokratike. Duke i dominuar tani hordhitë antireformë të Saliut, ajo po e dominon dhe Ramën me politikë.

Likuidimi i të korrumpuarve të PD-së kuptohet që erdhin nga akti naiv i Berishës.

Berisha pasi iu imponua deputetëve të PD-së që këta të dilnin nga Parlamenti duke djegur mandatet e deputetit, menjëherë deklaroi: "Ka krizë elektorale, janë manipuluar zgjedhjet" dhe prandaj duhet të dekretoheshin zgjedhjet e reja parlamentare.

Por, menjëherë politika amerikane deklaroi që nuk ka krizë dhe, edhe Parlamenti është legjitim, edhe zgjedhjet e vitit 2017 janë legjitime.

Por, pasi pranoi me deklaram që nuk ka krizë dhe as jolegjitimitet të Parlamentit, me një politikë



shumë të hollë, politika amerikane përkrahu zëvendësimet në Parlament me deputetët e rinj të listave të pritjes, të cilët ishin të votuar njëllëj si edhe ata që lanë mandatet.

E gjithë kjo lojë e saktë politike, në raport të drejtë edhe me personalitetin e lartë që ka fjalë e politikës amerikane në Shqipëri, nuk i dha fare ushqim opozitarizmit jashtë Partisë Demokratike dhe i mpiu protestat, të cilat tani janë të reduktuara deri në mospërfillje.

Mbas kësaj, politika amerikane, e mbështetur edhe nga politika gjermane e dominoi vetë politikën shqiptare, duke e likuiduar menjëherë opozitën antireformë nga Parlamenti, sepse siç e thamë më lart, ajo hapur përkrahu deputetët e rinj zëvendësues. Realisht me

këtë kundërpërgjigje elokumente ndaj politikës së Berishës, politika ndërkombëtare e dominoi përfundimisht vetë Parlamentin për ta vendosur atë kryekrejt në shërbim të Reformës në Drejtësi.

III. Kjo ishte lëvizja me të cilën politika amerikane dominoi edhe vetë Ramën, sepse pas riformulimit të Parlamentit, Rama nuk ka më asnjë justifikim për Reformën në Drejtësi. Deri tani Rama justifikoihe se nuk kishte vota në Parlament. Kurse ndërkohë ndihet i mpirë politikisht, sepse e ka kërcënuar me fakte kompromentuese edhe "Zëri i Amerikës".

Mpirja e Ramës në fakt para katër ditësh i dha forcë KLP-së që të avancojë drejt përfundimit të SPAK-ut. Ngritja e SPAK-ut krijon realisht mundësinë juridike

Mpirja e Ramës në fakt para katër ditësh i dha forcë KLP-së që të avancojë drejt përfundimit të SPAK-ut. Ngritja e SPAK-ut krijon realisht mundësinë juridike për fillimin e luftës antikorrupsion në rrethet e larta të politikës shtetërore. Dhe kjo në vetvete do të hapë epokën e re të shoqërisë shqiptare, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Kosovë, në Mal të Zi dhe në Maqedoni. Eliminimi i klasës së korrumpuar politike në Tiranë do të ndryshojë menjëherë vetë politikën e shtetit shqiptar me Serbinë dhe Maqedoninë, gjithmonë në favor të bashkimit kombëtar të të gjithë botës shqiptare në Ballkanin Perëndimor.

për fillimin e luftës antikorrupsion në rrethet e larta të politikës shtetërore. Dhe kjo në vetvete do të hapë epokën e re të shoqërisë shqiptare, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Kosovë, në Mal të Zi dhe në Maqedoni. Eliminimi i klasës së korrumpuar politike në Tiranë do të ndryshojë menjëherë vetë politikën e shtetit shqiptar me Serbinë dhe Maqedoninë, gjithmonë në favor të bashkimit kombëtar të të gjithë botës shqiptare në Ballkanin Perëndimor.

Ka njëqind vjet që politika shqiptare ka luajtur kundër interesit shqiptar dhe në favor të fqinjëve pushtues. Eliminimi masiv i klasës së korrumpuar të politikës shqiptare krijon realisht strukturën e Arbërisë moderne. Edhe sot, korrupsioni në Tiranë dhe në Shkup është ai që errëson zhvillimin shqiptar. Madje, po ta shohësh me vëmendje analitike, edhe korrupsioni i politikës së lartë në Prishtinë nuk luan në interes të bashkimit shqiptar, se kuptohet që luan për interes të Beogradit.

Por, eliminimi tërësor i klasës së korrumpuar politike në Tiranë hap menjëherë historinë e re të shqiptarizmit në të gjithë Ballkanin Perëndimor, sepse menjëherë fillon likuidimi i krerëve shqiptarë të korrumpuar në Prishtinë dhe në Shkup.

E kuptoni tani se përse likuidimi i korrupsionit të lartë politik në Tiranë është domosdoshmëri historike për zhvillimin gjithëshqiptar në Ballkanin Perëndimor? Dhe, e kuptoni gjithashtu se përse politika e Perëndimit të lartë është e interesuar kryekrejt për ta mbaruar me sukses në Shqipëri Reformën në Drejtësi?

## HOROSKOPI

### DASHI

Nuk është e nevojshme që të dini çdo detaj për tu përfshirë në një diskutim. Sa i përket financave, do të jetë e nevojshme që të merrni masa shtesë sa i përket një investimi.

### DEMI

Bëni kujdes nga njerëzit, të cilët nuk e kanë problem që të shkelin mbi çdokënd për të arritur qëllimet e tyre. Këta njerëz nuk do ta kenë problem të shkelin edhe mi ju. Në aspektin profesional do t'ju duhet të tregoni guxim me vendimet.

### BINJAKET

Edhe nëse po ndodhin shumë gjëra në jetën tuaj, duhet t'i jepni vetes kohë të mjaftueshme për të menduar rreth ndjenjave. Çështjet e zemrës kanë nevojë të rishikohen dhe të merrni vendime të reja.

### GAFORJA

Megjithëse është gjithmonë diçka e zgjuar që të ruani reputacionin për sjellje të mirë, nuk ka ligj që thotë se nuk mund të ndryshosh qëndrimin herë pas here. Në aspektin profesional, mund të përballeni me shkopinj nën rrota.

### LUANI

Miqët tuaj do të jenë aksesori i përsosur sot, duke ofruar një frymëzim dhe një dozë të kthjellët realiteti. Në punë do të përballeni me xheloz, kjo për shkak të aftësive tuaja. Njerëz aspak pozitivë do të përhapin thashetheme të pavërteta rreth jush.

### VIRGJERESHA

Pjesa më e mirë e ditës së sotme do të jetë fakti që më në fund do të jeni në gjendje të largoni një pengesë nga jeta juaj. Lehtësimi që do të ndjeni, do t'ju mbajë gjatë ditës plot energji dhe me ide të reja.

### PESHORJA

Lajme të mira mund të merrni sot sa i përket profesionit tuaj. Një promovim mund të vijë papritur, duke përmirësuar të gjithë ditën tuaj. Sot është një ditë e mirë për të nisur një raport të ri dashuror.

### AKREPI

Mos harroni të vlerësoni gjërat që keni në jetën tuaj tani. "Bari" është gjithnjë më i gjelbër në anën tjetër të gardhit, por ana juaj e gardhit është shtëpia jote, mos e pranoi atë si më të mirë. Do të ketë një nxitje të fortë për të provuar diçka të re dhe emocionuese sot.

### SHIGJETARI

Sfidat me të cilat po përballeni sot nuk do të përqendrohen rreth asaj se kush është më i zgjuari, cilin është më i shpejtë ose kush është më i miri. Faktori kyç në gjithçka sot është sa sa të fokusuar jeni në marrjen e asaj që dëshironi?

### BRICJAPI

Tregohuni shumë i kujdesshëm me paratë sot. Mund të ndodhë që për një moment mund të humbini shumën të majme, veçanërisht nëse merreni me lojëra fati. Në dashuri gjërat kanë nevojë për më shumë nxitje.

### UJORI

Ka shumë gjëra që kërkojnë vëmendjen tuaj, por aspekti profesional kërkon më shumë kujdes. Persona të caktuar mund të përqipen t'ju pengojnë të arrini qëllimet tuaja që janë pozitive. Mos u shkurajoni, por tregoni vendosmëri.

### PESHQIT

Sot mund të jetë një ditë shumë e ngarkuar në punë. Kjo është një nga ato ditë ku niveli i energjisë nuk do të jetë maksimal. Në dashuri, mos-marrëveshjet do të jenë të dukshme.

**Peshëngritësi është lënë në harresë**

**Calja akuzon: Ministria as nuk kujtohet për një kampion Europe!**

Në dy vitet e fundit ka fituar 4 medalje ari dhe 2 argjendi. Bëhet fjalë për peshëngritësin Briken Calja, i cili u shpall nënkampion i Europës para pak ditëve në Kampionatin Europian të Peshëngritjes në "Batumi 2019". Ndërkohë, peshëngritësi nga Shtërmeni përfaqësoi më së miri ngjyrat kuqezi, teksa arriti të merrte medal-

je të artë në stilin e shkëputjes duke ngritur 158 kilogramë. Ndërkaq, në stilin e shtytjes, Calja e mbylli vendin e dytë, po i dyti edhe në peshën totale, duke marrë dy medalje të

argjendta. Megjithatë, sërish Briken Calja nuk ka marrë vëmendjen e merituar nga mediat, ndërkohë që edhe nga Ministria e Arsimit apo zyrtarë të ministrisë as nuk e kanë uruar

peshëngritësin për arritjen, teksa edhe njëherë tjetër Calja nderoi flamurin shqiptar në Europë. Për këtë ka reaguar vetë sportistit në një postim të gjatë në "Facebook", ku ndër të tjera

thekson: "Në vendin tonë, kjo gjë kalohet sikur të jetë një arritje e rëndomtë dhe krejt normale. Çfarë duhet të bëjmë më shumë në peshëngritësit që ndaj nesh të ketë një sjellje të duhur dhe dinjitoze? Për median, kjo gjë u kalua si diçka krejt standarde e normale. Më falni, duhet të jetë patjetër Brikeni nëpër studiot tuaja që të flitet për medaljet historike të sjella këto dy

vite për Shqipërinë? Po ju përcjell lajmin që akoma nuk kam marrë asnjë telefonatë apo mesazh nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, apo qoftë nga ndonjë zyrtar i saj. As edhe një urim të thjeshtë! Zero! Mua si Briken kjo gjë nuk më duket normale dhe nuk duket normale për asnjë person mesatar në nivelin e kuptueshmërisë. Çfarë duhet të bëjmë më shumë një kampion Evrope?".

FSHF-ja ka njoftuar një konferencë për shtyp të presidentit Duka, pritet të vuloset çdo gjë

**Sot bëhet zyrtarizmi, Reja trajneri i ri kuqezi**

*73-vjeçari do të drejtojë për herë të parë një Kombëtare*



Jeton Selimi

Edi Reja do të jetë pasuesi i Panuçit në stolin e Kombëtares, me Armand Dukën i cili do të bëjë prezantimin e italianit të mërkurën në orën 15:00. Si gjithnjë de-tajet bëjnë diferencën, aq më tepër në një tratativë të tillë, e cila ka nisur fill pas humbjes kundër Turqisë. Të bindje Edi Rejan nuk ishte aspak e lehtë, aq më tepër që tekniku 73-vjeçar kishte 3 vite që nuk pranonte asnjë ofertë. Në karrierën e tij të pasur, Reja nuk kishte drejtuar kurrë më parë një përfaqësues, gjithashtu ky ishte një detaj të cilin Reja e vlerësoi shumë, të niseje një aventurë të re në këtë pikë të karrierës së tij nuk ishte e lehtë. Ajo që të bën përsh-typpje në këto negociata ka të bëjë me ofertën e parë të FSHF-ës. Armand Duka i ofroi ish-trajnerit të Napoli, Lacios etj., një kontratë 2-vjeçare, por Reja e refuzoi këtë duke pranuar



të jetë në "provë" deri fund të këtij viti, një periudhë e mjaftueshme që të dyja

palët të kuptojnë nëse do të vazhdojnë edhe më tej. Pra, kualifikueset "Euro

2020" janë një provë për Edy Rejan, nëse rezultatet janë të kënaqshme, të dyja

palët mund të rinovojnë qetësisht kontratën. Italiani ka zgjedhur edhe stafin e tij, Alesando Kalori do të jetë ndihmësi i tij. Ndryshe nga Panuçi, Reja pritet të përfitojë 25 mijë euro në muaj, këtu nuk përfshihet paga për pjesën tjetër të stafit të tij. Gjithashtu, në rast kualifikimi për në Europian do të ketë dhe një premio prej 200 mijë euro. Reja ka nisur menjëherë punën teksa sipas mediave italiane ishte i pranishëm të hënën në mbrëmje në stadiumin "Atleti Azzurri", ku ndoqi drejtpërdrejtë sfidën Atalanta-Empoli, një mundësi për të parë nga pranë Frederik Veselin, pasi Berisha dhe Gjimi-shiti ngrohën stolin.

**CHAMPIONS LEAGUE**


**Poçetino: E kalojmë Sitin, kemi besim te forca jonë**

Trajneri i Tottenham, Mauricio Poçetino, ka folur në konferencë për shtyp, në kuadër të ndeshjes së kthimit të Champions League, ku Tottenhami i tij do të udhëtojë Manchester për t'u përballur me Sitin. "Spursat" kanë fituar ndeshjen e parë me rezultatin 1-0, por trajneri argjentinas e di mjaft mirë se ende asgjë nuk ka përfunduar. "Fakti që mundëm Sitin në ndeshjen e parë na ka kënaqur, por e dimë shumë mirë se çdo gjë mbetet e ende e hapur. Ne duhet të kemi besim te vetja jonë dhe te forca jonë. Do të luftojmë. E dimë që ata janë shumë të fortë dhe se do të sulmojmë që nga fillimi, ndaj kjo për ne është një sfidë e madhe. Duam t'i limitojmë sa më shumë të jetë e mundur, të mbetemi ofensivë dhe pavarësisht gjithçkaje, të sulmojmë. Duhet të besojmë, mund t'i ndalin dhe të tregojmë aftësitë tona".

**GJOBA PËR LOJTARËT**

**Sherri në Milan-Lacio, pezullohet Igli Tare**

Nuk ia ka hedhur pa lagur Igli Tare, drejtori sportiv i Lacios, që në përfundim të ndeshjes kundër Milan-it shpërtheu ndaj gjyqtarit Roki për penalltinë e padhënë në favor të skuadrës bardhekal-tër, çka mund t'u kushtojë kryeqytetasve vendin në Champions League edicionin e ardhshëm. Gjykatësi sportiv e ka dënua Taren për "për sjellje kërcënuese ndaj gjyqtarit dhe shprehive të rënda ndaj tij", duke e pezulluar nga stadiumet deri më 30 prill.



Gjoba edhe për "sherrxhinjtë" Bertolaçi, Kesie, Musakio, Luiz Felipe dhe Patriç, të cilët janë ndëshkuar me nga 10 mijë euro

secili. Gjorbë 10 mijë euro edhe për Milanin, pasi një tifoz kuqezi kishte pështyrë trajnerin e Lacios, Simone Inzagin.

**VENDIMI**

**Mallkimi i Drake, Roma u mohon lojtarëve të bëjnë foto me të**


Duket e pabesueshme, por është e vërtetë. Roma ka ndaluar lojtarët e saj që të bëjnë foto me reperin e famshëm kanadez, Drake, pasi ky i fundit konsiderohet si tersndjellës nga tifozët. Në një njoftim në profilin zyrtar në "Twitter", klubi verdekuq njofton se "të gjithë lojtarët e Romës e kanë të ndaluar të bëjnë foto me Drake deri në përfundim të sezonit". Në një moment shumë të rëndësishëm të sezonit, me Champions League që mbetet për t'u arrirë dhe në prag të sfidës direkte me Interin, Roma ka zgjedhur të shmangë "mallkimin Drake". Reperi kanadez



duket se influencën gjithnjë në aspektin negativ në rezultatin e ndeshjes, sidomos tek ato ndeshje ku lojtarët bëjnë foto me të. Gjithçka ka ardhur pas një fotoje të bërë me Obaing, ndërsa Arsenali u mposht nga Ervertoni dhe doli jashtë zonës Champions. Nuk i eci mbarë

as Agueros, që publikoi një video me reperin dhe humbi një penallti për Sitin në përballjen e fituar nga Tottenhami në Champions. I njëjti fat dhe për Borussia Dortmund, që pas fotos së Sanços me Drake u mposht 5-0 nga Bajerni. Më pas Pogba, foto me Drake dhe Manchester Junajid humbet me Barcelonën në shtëpi, për të vijuar me Kurzavën, që pa Parisin e tij të shkërmoqet 5-1 nga Lila. Ndaj, të Roma mendojnë se për momentin Drake duhet të mendojë vetëm të performojë në skenë dhe të mos dalë foto me lojtarët verdekuq!

**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

1. Pausini këngëtare
5. Më e mira është rekord.
9. Inicialet e Pacino-s.
11. Alessandro i pilës.
12. I ka zyrat në kufij
13. Haan ish-trainer.
14. Gjysmë mirmoze.
15. Fillojnë sefte.
16. Ishte shkollë e Aristotelit.
20. Shuhen në qendër.
22. Bëhen me ambalazh.
23. Janë idhnakë.
25. Fillojnë titujt.
26. Do të bëhen pemë.
27. Ashtu si jeton heremitit.
29. Eshhtë dhomë e lartë.
30. Janë spanjollët dhe portugezët.

32. Ishte filozofi që preu damarët.
34. Janë gjuhë...veshi.
35. Eshhtë numri i dytë tek.
36. Triolet shkrimtare.
37. Kufizojnë takimet.
38. Tyler aktore.
39. Mbledh baskët separatistë.
40. Fillojnë kalimin.
41. Inicialet e Delon.
43. Lumi i Bernës.
44. Eshhtë numri të parit.
45. Një thirrje me emra.

**VERTIKAL**

1. Flori pa kufij.
2. Një Baba përrallor.
3. Lempër këngëtare gjermane.
4. Rastisin në krye.
5. Ai ekzekutiv u bë bashki.
6. Qendra e drogës.
7. Një tabu islamike.
8. Mbyllin një dyqan.
10. Janë si zotime.
11. Kryeqyteti i Lichtenstein.
12. Jaë shtyllat për vela
14. Ata të Ferrari-t qëndrojnë në box.
16. Duhet fituar me djersë.
17. Piktura pa kura.
18. Janë dokumente partie.
19. Në fund të vitit.
21. Farkëtoi armët e Aklit.
22. Një është për kërcim.
24. Athinaja e romakëve.
25. Janë kapriçit.
27. Një tis mjegulle.
28. Kërcimi i Fred Astaire.
31. Edëards regjisor.
33. Parker regjisor.
38. Luan në kufij
39. Inicialet e Rohmer.
42. Fillojnë detyrën.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


1. Matia... që këndojnë Vacanze romane.
5. Janë vendet e lira
11. Parajsja e humbur.
13. Comaneci e famshme e gjimnastikës.
15. Ekstremitë në sirtar.
16. Eshhtë nofka.
17. Një treshe në skenë.
19. Një provë inteligjence.
21. Gjysmë latimi.
23. Gjysmë eolike.
24. Ekstremitë në studim.
25. Bëjnë stil të lirë
28. Fillojnë kastile
29. Kalimi në kufij.
30. Një tragjedi... e Dreiser.
33. Grier aktore.
34. Dashi kur mungon ai
36. Eshhtë zanore në filma
38. Kufizohet në kufij
39. Ente Civile Europiane.

**VERTIKAL**


40. Janë galeri në hekurudhë.
41. Ramazzotti këngëtar
42. Mbyllin një tender.
43. Arjençi Formacioni Tiranë.
44. Eshhtë pjesë e borxhit që paguhet.
46. Gjysmë tandem
48. Jessica Parker aktore.
49. Inicialet e Presley.
50. Shteti i francezëve.
51. Janë brinjët në skuadër.
52. Qendër fitimi
8. Inicialet e Daudet.
9. Ndërmarrje Industriale Tiranë.
10. Iglitë Lazio.
12. Janë zjarrvënës.
14. Frolich e Marlene Dietrich.
17. Kufizojnë rastet.
18. Shkrofi Rinoceronti.
20. Ekstremitë në slam.
22. Janë trille.
25. Oytet Italian.
26. Jepen për hartim.
27. Fillojnë takimet.
29. Kufizojnë kënde.
31. Janë vendet e para.
32. Një greminë.
35. Eshhtë llogarim që qërohet.
36. Ndihen me ilaçe.
37. Massari aktore italiane.
38. Janë kapot.
40. Numri i oktetit.
41. Kush ka... fërgëllon.
44. Një i fundit mbi të gjithë.
45. Një pjesë e satelitëve.
47. Në mes të një kanali.
48. Derisa janë në fund.
49. Inicialet e Taylor aktore.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

**FJALËKRYQI (1)**

GARRROS ADAPTIMI  
URAT IPRIITIAA  
UKRONIKA EGT  
SFI VALENTINO  
LMINOTARIK  
REB DITARI TA  
NOTERITIROALAN  
NOTIA ESENIIN  
DRAMA TISHIRKT  
OTEA NERLEJEA  
REFRANTRIKELG  
FANI KUFITARTARI  
ORAR NFPRAIR  
KAKILITELTI  
GAS ATALAN TAS  
TELEKOMEDIA  
AMANEITKRE  
HEREMIT ROBERTI  
TSRIMARAT  
ASGREME T S AL  
RI JANIS EMILIE  
RI ETH KANAAN  
TIRANA ALLETEI

**FJALËKRYQI (2)**

MATIA...  
JANË VENDET E LIRA  
PARAJSA E HUMBUR  
COMANECI E FAMSHME E GJIMNASTIKËS  
EKSTREMITË NË SIRTAR  
ESHËTË NOFKA  
NJË TRESHE NË SKENË  
NJË PROVË INTELIGJENCE  
GJYSMË LATIMI  
GJYSMË EOlike  
EKSTREMITË NË STUDIM  
BËJNË STIL TË LIRË  
FILOJNË KASTILE  
KALIMI NË KUFIJ  
NJË TRAGJEDI... E DREISER  
GRIER AKTORE  
DASHI KUR MUNGON AI  
ESHËTË ZANORE NË FILMA  
KUFIZOHET NË KUFIJ  
ENTE CIVILE EUROPIANE  
JANË GALERI NË HEKURUDHË  
RAMAZZOTTI KËNGËTAR  
MBYLLIN NJË TENDER  
ARJENÇI FORMACIONI TIRANË  
ESHËTË PJESË E BORXHIT QË PAGUHET  
GJYSMË TANDEM  
JESSICA PARKER AKTORE  
INICIALET E PRESLEY  
SHTETI I FRANCEZËVË  
JANË BRINJËT NË SKUADËR  
QENDËR FITIMI  
INICIALET E DAUDET  
NDËRMARRJE INDUSTRIALE TIRANË  
IGLITË LAZIO  
JANË ZJARRVËNËS  
FROlich E MARLENE DIETRICH  
KUFIZOJNË RASTET  
SHKROFI RINOCERONTI  
EKSTREMITË NË SLAM  
JANË TRILLE  
OYTET ITALIAN  
JEPEN PËR HARTIM  
FILOJNË TAKIMET  
KUFIZOJNË KËNDE  
JANË VENDET E PARA  
NJË GREMINE  
ESHËTË LLOGARIM QË QËROHET  
NDIHEN ME ILAÇE  
MASSARI AKTORE ITALIANE  
JANË KAPOT  
NUMRI I OKTETIT  
KUSH KA... FËRGËLLON  
NJË I FUNDIT MBI TË GIJTHË  
NJË PJESË E SATELITËVË  
NË MES TË NJË KANALI  
DERISA JANË NË FUND  
INICIALET E TAYLOR AKTORE

**SUDOKU**

		4			5			
	4		6		8			
		2		8	4			
			3	5			6	
9	5		1	2				
6	7							
7						8	1	
1			9				2	
5					7			

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

8	4	9	6	5	1	3	7	2
5	6	2	8	7	3	4	9	1
3	7	1	9	2	4	8	5	6
7	8	6	4	9	2	5	1	3
9	5	4	3	1	7	6	2	8
1	2	3	5	6	8	7	4	9
2	3	8	1	4	5	9	6	7
6	1	5	7	3	9	2	8	4
4	9	7	2	8	6	1	3	5

*Argëtim filozofik*

- Të drejtat e grave janë detyrime të burrave ...
- Trishtimi i tepër qesh. Gëzimi i tepruar qan.
- Të gjithë jetojmë nën të njëjtin qiell, por jo të gjithë kemi të njëjtin horizont.
- Mos zgjidhni një rrugë pa pengesa, me siguri nuk do të të çojë askund.
- Kush nuk di dhe nuk e di se nuk di, është i çmendur, shmangeni atë.



**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

8	6	8	3	6	4	13	1	16	5	13
2	5	2	5	7	4	8		6	6	4
4	4	19	4	11	1	2	5	20	5	2
12		11	5	6	5	13	5	9	4	7
5	12	4	2	5	6	3	2	9	5	5
		6	4	2	4	1		4	1	5
5	2	4	3	7		6	3	4	6	1
13	3	12	3	2	3	4	2	5	13	5
2	13	16		2	5	A	5	12		2
1	2	4	2	4		G	6		2	13
4	18		7	4	8	I	1	12	5	6
3	13	8	2	6	3	M	4	8	2	3

M E R L U C K A S F  
A M A R A T O N I S T I  
C A K A N A L E T A J  
E K I N E T I K E F E  
K O M I T E P R E T  
E U I A T A L E A T  
N A H I F A R S A T  
D J A L L P A S T A  
R T K E T T T A C  
R U D H A I R U F I  
A N J A C K A R I E L  
T I P A R E T T R U R I

- Kush nuk di dhe e di se nuk di, është fëmijë, arsimoje.
- Kush di dhe nuk e di se di, është në gjumë, zgjoje atë.
- Kush di dhe e di se di, është i mençur, ndiqeni.
- - "Forma më e lartë e inteligjencës njerëzore, është aftësia për të vëzhguar pa gjykuar."
- - Kur një njeri të shkakton zemërim, do të thotë se ai është më i fortë se ti.

*Thënie të mençura*

